

FaithLife Ministries

"Pajisja e drejtuesve të kishës në mbarë botën"

Menaxhimi **për drejtuesit e kishës**

Manual trajnimi

Vëllimi nr. 1

**"Të ndihmojmë drejtuesit e kishës të menaxhojnë
shërbesën në të cilën Perëndia i ka thirrur të drejtojnë"**



2010, 2006, 2002 by Barry Voss

FaithLife Ministries, Inc.

www.faithlifeministries.net

Telefon: (770) 492-4903

Email: BarryVoss@comcast.net

Hyrje

Ky manual trajnimi është hartuar për t'i ndihmuar pastorët, stafin e kishës dhe drejtuesit e shërbesës në menaxhimin dhe administrimin e detyrave të shërbesës ku janë thirrur. Ndërkohë që shumë seminare (shkolla teologjike) dhe kolegje biblike i përgatisin pastorët dhe drejtuesit e shërbesave për të predikuar, mësuar dhe ungjillëzuar, shpesh kurikulumi i tyre nuk përfshin ndonjë trajnim për aftësitë kryesore të menaxhimit. Meqenëse shumica e pastorëve dhe e drejtuesve të kishave duhet të udhëheqin njerëzit, të menaxhojnë burimet dhe të administrojnë në kishat e tyre, ky lloj trajnimi është thelbësor për t'i përgatitur për atë që do të thirren për të bërë pasi të jenë caktuar në shërbesën e tyre.

Autori ka trajnuar drejtues kishash dhe shërbesash në fushën e misionit që nga viti 1996. Ky manual e pati filluesin e vet kur ne identifikuan, pas disa vitesh pune me pastorë në vende të ndryshme, se kishte një mungesë të burimeve dhe të materialeve trajnuese për menaxhimin. Ishte e qartë, në atë kohë, se as nuk kishte aq shumë material të tillë të disponueshëm ose që tashmë jepej mësim. Për këtë arsye, meqenëse shumë pastorë dhe drejtues në vendet e pazhvilluara nuk kanë mundësi të marrin një trajnim bazë për menaxhimin, FaithLife Ministries ka përgatitur këtë material për të plotësuar këtë nevojë.

Materiali në këtë manual trajnimi është hartuar për të ofruar një nivel themelor të të kuptuarit dhe të trajnimit për mjetet dhe teknikat e menaxhimit nga një pikëpamje e krishterë dhe biblike. Kur këto mjete dhe teknika zbatohen me udhëheqjen dhe me mbështetjen në Frymën e Shenjtë, ne besojmë se ato do të sjellin “fryt për Mbretërinë” (Kolodianëve 1:10).

2010, 2006, 2002 nga Barry Voss, FaithLife Ministries, Inc.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem përtëritës apo të transmetohet në çfarëdo mënyre elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo ndonjë mënyrë tjetër, pa lejen paraprake të autorit, me përjashtim të rasteve që parashikohen nga ligji për të drejtën e autorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Bëhet përjashtim kur materiali përdoret në përputhje me synimin e tij për përdorim lokal (pa pagesë), rast në të cilin lejohet dhe inkurajohet kopjimi në masë.

Për FaithLife Ministries

FaithLife Ministries u themelua në janar të vitit 2001 nga Barry Voss dhe Kim Star-Voss për të siguruar trajnim dhe burime shërbese për drejtuesit e krishterë në të gjithë botën. Ata kanë thirrje dhe pasion për dishepullizimin, pajisjen dhe trajnimin e njerëzve të Perëndisë për shërbesë, në veçanti në vende të botës ku ka pak mundësi ose financa për burime të tilla. Ata kanë trajnuar pastorë dhe drejtues shërbesash për fëmijë, të rinj dhe të rritur në vende të ndryshme, me theks në zhvillimin e aftësive drejtuese për shërbesa. Përveç drejtimit të konferencave dhe të seminareve trajnuese, ata krijojnë dhe zhvillojnë burimet dhe materialet e tyre trajnuese dhe përpiqen t'u japin zemër të gjithë besimtarëve të jetojnë një jetë me besim.

Kim më parë ka qenë drejtuese e dishepullizimit të fëmijëve te kisha “Christ the Shepherd” (“Krishti bariu”) në Alfaretta, Xhorzhia, ku u shërbente mbi 500 fëmijëve dhe të rriturve. Përveç përvojës së saj në shërbesë, Kimi ka punuar dhe për mbi 15 vjet si menaxhere e sistemeve dhe projekteve kompjuterike në disa korporata të mëdha. Aktualisht Berri është i punësuar me kohë të plotë në këtë shërbesë dhe ka mbi 20 vjet përvojë në menaxhimin e bizneseve. Gjithashtu, ai është i përfshirë në adhurim dhe në shërbesën e burrave në kishën e tyre. Kimi dhe Berri kanë 35 vjet martuar dhe kanë dy fëmijë të rritur.

Mirënjohje

Duam të shprehim falënderime së pari ndaj Perëndisë, që e bëri të mundur këtë projekt dhe që na dha vizionin për të hartuar këtë manual trajnimi. Gjithashtu, duam të falënderojmë Ken Jacques, Daryl Hoh, Doming Orprecio, Ayub Khayo dhe David Quispirroca për ndihmesën e tyre në redaktim dhe në dhënien e ideve për këtë material.

Menaxhim për drejtuesit e kishës

Vëllimi 1

Tabela e përmbajtjes

Pjesa 1: Menaxhimi i shërbesës

- Kapitulli 1 Drejtimi në shërbesë
- Kapitulli 2 Të qenët një drejtues biblik
- Kapitulli 3 Stilet e drejtimit
- Kapitulli 4 Zhvillimi i drejtuesve

Pjesa 2: Menaxhimi i njerëzve


- Kapitulli 5 Dhuntitë frymërore
- Kapitulli 6 Menaxhimi i njerëzve
- Kapitulli 7 Menaxhimi i konfliktit
- Kapitulli 8 Bërja e dishepujve

Pjesa 3: Menaxhimi i burimeve

- Kapitulli 9 Planifikimi strategjik
- Kapitulli 10 Menaxhimi i parave
- Kapitulli 11 Menaxhimi i kohës
- Kapitulli 12 Menaxhimi i informacionit

Pjesa 1

Drejtimi në shërbesë



Kapitulli 1

Drejtimi në shërbesë

“Ruani tufën e Perëndisë midis jush, duke e mbikëqyrur jo me detyrim, por me vullnet të lirë, jo për përfitim të pandershëm, po me vullnet të mirë, dhe jo si zotërues mbi ata që ju janë besuar, por duke u bërë shembull për tufën. Dhe kur të shfaqet kryebariu, do ta merrni kurorën e lavdisë që nuk fishket”.

1 Pjetrit 5:2-4

Aftësitë e forta drejtuese janë të rëndësishme për çdo drejtues kishe. Pa to, shumë drejtues të krishterë e kanë jashtëzakonisht të vështirë t’i çojnë shërbesat përpara dhe t’i angazhojnë njerëzit në misionin e kishës. Drejtimi mund të përkufizohet thjesht si ato aftësi që bëjnë të mundur që individit të nxisë të tjerët për të arritur një qëllim ose rezultat të dëshiruar. Por drejtimi ka të bëjë dhe me pasjen e një vizioni e të një plani, zhvillimin e njerëzve dhe përqendrimin në përmbushjen e qëllimeve. Në këtë kapitull do të shikojmë 5 mënyrat për drejtim efektiv shërbese.

Pyetje: Çfarë duhet të ketë çdo drejtues për t’u konsideruar si i tillë?

Përgjigje: **Ndjekës!**

***Nëse nuk të ndjek njeri, ti nuk je drejtues.**

5 mënyra për drejtim efektiv shërbese

Nr. 1. Drejtuesit përdorin ndikimin, jo autoritetin

Gjoni 10:2-4

“Kurse ai që hyn nga dera është bariu i deleve. Atij ia hap portieri dhe delet e dëgjojnë zërin e tij, dhe ai i thërret delet e tij me emër dhe i prin jashtë. Dhe, pasi i ka nxjerrë delet e tij, shkon para tyre; dhe delet e ndjekin sepse e njohin zërin e tij”.

Drejtimi është ndikim

1. Duhet t’i motivoni të tjerët të veprojnë
2. Ju e fitoni ndikimin duke rritur besimin dhe respektin
3. Drejtimi është aftësia për t’i bërë të tjerët të ndjekin me dëshirë vendimet e tua

Autoriteti është pushtet

1. Sipas fjalorit, autoriteti është:
“pushteti për të ndikuar ose për të imponuar mendim, opinion ose sjellje”
2. Të jepet nga Perëndia
“Sepse nuk ka pushtet veçse prej Perëndisë”
- Romakëve 13:1
3. Autoriteti fitohet nga e kaluara, jo e tashmja
4. Autoriteti është aftësia për të yënë në zbatim vendimet e tua

Si duhet ta përdorim autoritetin tonë?

- Për të mësuar
“Por ti fol ato, që i kanë hije doktrinës së shëndoshë. Këshillo dhe qorto me çdo pushtet”. – Titi 2:1 & 15
- Për të shërbyer
“Ruani tufën e Perëndisë midis jush, duke e mbikëqyrur jo me detyrim, por me vullnet të lirë, jo për përfitim të pandershëm, po me vullnet të mirë” –
1 Pjetrit 5:2

****Gjithnjë është më mirë të drejtosh me ndikimin tënd sesa me autoritetin tënd**

Kur përdor ndikimin tënd, njerëzit duan të të ndjekin

Kur përdor autoritetin, njerëzit duhet të të ndjekin

- Shpesh njerëzit largohen nga shërbesa juaj
- Shkaktoni kundërshti

Nr. 2. Drejtuesit kanë vizion

Fjalët e Urta 29:18 – “Kur nuk ka një vizion profetik, populli bëhet i shfrenuar”.

1. Një drejtues e di se ku do që të shkojë
2. Pa vizion, një kishë nuk ka drejtim
Vizioni siguron fokus
Qartëson pikësynimin dhe qëllimet e kishës
3. Vizioni përcakton qëllimin dhe synimin e shërbesës
Synimin e tij përfundimtar, atë që po përpiqet të arrijë
Çfarë do që të jetë ose ku do që të shkojë
 - **Shembuj të Vizioneve**
 1. Të ndërtoj një ndërtesë të re për kishën brenda 12 muajve
 2. Të ngre një depo ushqimesh për të varfrit në komunitet

3. Të themeloj një shkollë të krishterë në komunitet
 4. Të arrij 10 000 njerëz me ungjillin
4. Vizioni bën të mundur që një kishë të përmbushë qëllimin e Perëndisë për të
- Një vizion i dhënë nga Perëndia zakonisht nuk është diçka të cilin mund ta arrijmë lehtësisht vetëm. **Gjoni 15:5 – “Pa mua nuk mund të bëni asgjë”.**
- Për kishën është e domosdoshme të kërkojë drejtimin e Perëndisë
- Mateu 19:26 – “Për njerëzit kjo është e pamundur, por për Perëndinë çdo gjë është e mundur”.**
5. Një Vizion për kishën e mobilizon dhe i jep energji asaj
 - Kur anëtarët kanë një vizion të përbashkët ka më shumë të ngjarë që të përfshihen
 - Një vizion u jep anëtarëve diçka për të cilën të punojnë
 - Një vizion i ndihmon njerëzit të ndihen pjesë e diçkaje të madhe

****Shënim: Një Vizion nuk është deklarimi i misionit**

Deklarimi i misionit tregon se çfarë bën, jo se ku po shkon

Si të hartosh një Vizion

- Hapi Nr. 1:** Lutu për drejtimin dhe zbulesën e Perëndisë
Kërkoni se si Perëndia mund t’ju përdorë në komunitetin tuaj ose në botë
Kërkoni se çfarë dëshiron Perëndia që të bëni për Të
- Hapi Nr. 2: Mendoni me ambicie të MADHE**
Mos e kufizoni veten me atë që keni
Lejojeni Perëndinë të sigurojë atë që keni nevojë
- Hapi Nr. 3:** Përfshini drejtues të tjerë në hartimin e vizionit
- Hapi Nr. 4:** Shkruajeni vizionin dhe peshoni alternativat ose mundësitë
Kaloni kohë për të menduar dhe për t’u lutur për to
Pyetni të tjerët për ide në lidhje me to
- Hapi Nr. 5:** Lutuni dhe zgjidhni vizionin tek i cili ndjeni se Perëndia po ju thërret!
- Hapi Nr. 6** Komunikojeni vizionin
Drejtuësit duhet ta komunikojnë vizionin shpesh për të rritur ndërgjegjësimin dhe përfshirjen
Si drejtues, ju duhet të jeni të përkushtuar ndaj Vizionit

Nr. 3. Drejtuesit kanë një plan

Fjalët e Urta 16:3

“Besoja Zotit veprimet e tua dhe planet e tua do të realizohen”.

- a. Një drejtues planifikon se si ta realizojë vizionin
Pa një plan ka shumë mundësi që nuk do ta realizoni vizionin
Një plan ju ndihmon të organizoni burimet dhe aktivitetet drejt vizionit
Një drejtues nuk mund të planifikojë pa një vizion
- b. Një drejtues menaxhon burimet e Perëndisë për vizionin e Perëndisë
Perëndia u jep drejtuesve burime për t'i përdorur
Perëndia pret që drejtuesit t'i përdorin burimet e Tij me mençuri
Perëndia pret të ardhura nga investimi i Tij
- c. Detyra e një drejtuesi është të planifikojë punën dhe të vënë planin në zbatim
Një drejtues duhet ta përditësojë vazhdimisht planin
Një plan i mirë e ndihmon drejtuesin të marrë vendime më të mira
Një plan i mirë shmang shpërdorimin e burimeve të Perëndisë

Nr. 4. Drejtuesit i zhvillojnë njerëzit

Luka 9:1-2

“Mbasi i thirri bashkë të dymbëdhjetë dishepujt e vet, u dha atyre fuqi dhe pushtet mbi të gjithë demonët dhe të shërojnë sëmundjet. Dhe i dërgoi të predikojnë mbretërinë e Perëndisë dhe të shërojnë sëmundjet”.

- a. Para së gjithash drejtuesit bëjnë dishepuj (**Mateu 28:19-20**)
Mësojnë dhe predikojnë Fjalën
U mësojnë atyre të binden
- b. Drejtuesit trajnojnë dhe i pajisin të tjerët për shërbesë
I njohin dhe përdorin dhuntitë frymërore të gjithsecilit
Inkurajojnë pjesëmarrjen në shërbesë
- c. Drejtuesit rekrutojnë dhe zhvillojnë drejtues të tjerë
Për të rritur shërbesën e tyre
Për të vijuar shërbesën
Sa më shumë drejtues ka, aq më e madhe është mundësia për sukses

Nr. 5. Drejtuesit përqendrohen te përmbushja

Romakëve 14:12

“Kështu, pra, secili nga ne do t'i japë llogari Perëndisë për veten e vet”.

- a. Drejtuesit fokusohen tek arritja e qëllimeve dhe te pasja e rezultateve
Një drejtues ka gjithnjë në mendje vizionin
Një drejtues e mat suksesin me anë të rezultateve
- b. Drejtuesit përqendrohen tek fushat me prodhimtarinë më të lartë për investimin e tyre
Një drejtues i kanalizon burimet tek fushat që kanë më shumë sukses
Një drejtues i braktis shërbesat që s'japin fryt
- c. Drejtuesit e kuptojnë se veprimtaria nuk është arritje
Një drejtues i mat shërbesat sipas efektshmërisë që ato kanë
Një drejtues i vlerëson aktivitetet për ndikimin që kanë te vizioni

Luka 10: 38-42

“Por ndodhi që, ndërsa ata po udhëtonin, Jezusi hyri në një fshat; dhe një grua, me emër Marta, e priti në shtëpinë e vet. Dhe ajo kishte një motër që quhej Maria, e cila u ul te këmbët e Jezusit dhe dëgjonte fjalën e tij. Por Marta, ishte tepër e zënë nga shërbimet e shumta, dhe mbasi iu afrua i tha: "Zot, a nuk do të dish që ime motër më la vetëm të shërbej? I thua, pra, të më ndihmojë". Por Jezusi, duke u përgjigjur, i tha: "Martë, Martë, ti po shqetësohesh dhe mundohesh për shumë gjëra; por një gjë është e nevojshme, dhe Maria zgjodhi pjesën e mirë, që asaj nuk do t'i hiqet".

(Ky Shkrim ilustron argumentin se Marta preokupohej për bërjen e gjërave, kurse Maria për përmbushjen.)

Misioni dhe Vizioni

1. Shkruani një deklaratë Misioni (Çfarë po ju thërret Perëndia që të bëni për Të?)

2. Shkruani një deklaratë Vizioni (Cilin qëllim për shërbesë po ju kërkon Perëndia që të përmbushni?)

****Deklarata e Vizionit duhet të përmbajë një mënyrë për të matur përmbushjen e saj**

Kapitulli 2

Të qenët një drejtues biblik

“Unë jam hardhia, ju jeni shermendet; kush qëndron në Mua dhe Unë në të, ai jep shumë fryt, sepse pa mua nuk mund të bëni asgjë. Në qoftë se ndokush nuk qëndron në Mua, hidhet jashtë si shermendi dhe thahet; pastaj i mbledhin, i hedhin në zjarr dhe digjen. Në qoftë se qëndroni në Mua dhe fjalët e Mia qëndrojnë në ju, kërkon çfarë të doni dhe do t'ju bëhet. Në këtë është përlëvduar Ati im, që të jepni shumë fryt, dhe kështu do të bëheni dishepujt e Mi.”

Gjoni 15:5-8

Kur drejton të tjerët, ndjekja e parimeve biblike është mbase gjëja më e rëndësishme që duhet të synojë një drejtues, sepse kjo është ajo që Krishti erdhi të na mësojë. Edhe pse nuk duket se gjithnjë ka kuptim për ne, nëse ndjekim rrugën e Perëndisë në vend të rrugës sonë, do të kemi një shërbesë shumë më efektive. Mund të zotërojmë një aftësi të jashtëzakonshme drejtimi, por nëse ajo nuk bazohet në Fjalën e Perëndisë, atëherë ka shumë mundësi që po i drejtojmë ndjekësit tanë në drejtimin e gabuar. Në këtë kapitull do të shohim 10 tipare biblike të drejtuesve të efektshëm dhe sfidat që ndeshin drejtuesit në ditët e sotme.

I. Hyrje

Cili është synimi i drejtuesit të krishterë?

NUK është të rrisë numrin dhe përfshirjen (e njerëzve në kishë).

Është **Të shohë Krishtin të modeluar te të tjerët!**

“Djema të mi, që unë i lind përsëri, derisa të formohet Krishti në ju”! (Galatasve 4:19)

Ku ndryshon një drejtues i krishterë nga një drejtues jo i krishterë?

Ai e di se — **“Pa Perëndinë nuk mund të bëjë asgjë”! (Gjoni 15:5)**

II. Tiparet e drejtimit: Një drejtues efektiv shfaq 10 tiparet e mëposhtme:

1. Një drejtues efektiv duhet të jetë **Vizionar.**

“Kur nuk ka një vizion profetik, populli bëhet i shfrenuar”. Fjalët e Urta 29:18

Duhet të përcaktoni synimet

Duhet ta shprehni vizionin në një mënyrë që të tjerët të marrin pjesë në të

Shembull: **Moisiu** (mori vizionin në ferrishtën që digjej - Eksodi 3)

2. Një drejtues efektiv duhet të jetë **I prirur për Mision.**
“Atëherë u tha dishepujve të vet: "E korra është me të vërtetë e madhe, por punëtorët janë pak. Lutjuni, pra, Zotit të të korrave, të dërgojë punëtorë në të korrat e tij". Mateu 9:37-38
 Të jetë i përqendruar për të arritur jobesimtarët.
 Të interesohet për dishepullizimin e besimtarëve të tjerë.
 Shembull: **Pali** (bëri shumë udhëtime misionare – Veprat e Apostujve)

3. Një drejtues efektiv duhet të jetëi **Pasionuar.**
“Tani përfundojeni edhe bërjen që, ashtu si që dëshira për të dëshiruar, kështu të jetë edhe për ta përfunduar sipas mundësive që keni”. 2 Korintasve 8:11
 Ju duhet ta keni fort për zemër shërbesën tuaj.
 Ju duhet të jeni të përkushtuar për t’ia dalë mbanë (pasion = përkushtim).
 Shembull: **Stefani** (ai ishte i përkushtuar për çështjen, kauzën - Veprat e Apostujve 7)

4. Një drejtues efektiv duhet të jetë**I udhëhequr nga Fryma.**
“Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut”. Veprat e Apostujve 1:8
 Lëreni Frymën e Shenjtë t’ju udhëheqë.
 Qëndroni të lidhur me burimin e fuqisë suaj – Frymën e Shenjtë!
 Shembull: **Danieli** (ai nuk e mohoi besimin e tij – Danieli 6)

5. Një drejtues efektiv duhet të jetënjë **Shërbëtor.**
“por kështu nuk do të jetë ndër ju; por kush të dojë të bëhet i madh ndër ju, le të jetë shërbënjësi juaj; edhe kush të dojë të jetë i parë ndër ju, le të jetë shërbëtori juaj – Ashtu si Biri i njeriut nuk erdhi që t’i shërbehet, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si shpërblësë për shumë veta”. Mateu 20:26-28
 Një drejtues është thirrur t’u shërbejë ndjekësve të tij dhe jo t’i shërbejnë ata.
 Një drejtues shërbëtor i ndihmon ndjekësit e tij të rriten dhe të kenë sukses.
 Shembull: **Jezusi** (larja e këmbëve të dishepujve – Gjoni 13)

6. Një drejtues efektiv duhet të jetëi **Përqendruar.**
“Vëllezër, unë, nuk e llogaris veten time se e kam kapur, por një gjë po bëj: duke harruar ato që kam lënë pas dhe duke u zgjatur drejt atyre që kam përpara, po ndjek pas synimin, drejt çmimit të thirrjes së lartme të Perëndisë në Krishtin Jezus”. Filipianëve 3:13-14
 Mos u shpërqendroni nga çështje që nuk kanë lidhje me vizionin dhe

misionin tuaj.
Mos lejoni që Satani t'ju shmangë nga shtegu juaj.

Shembull: **Nehemia** (përqendrim në rindërtimin e tempullit të Jerusalemit – Nehemia 6)

7. Një drejtues efektiv duhet të jetë**i Guximshëm**.

“Pastaj Moisiu thirri Jozueun dhe i tha në prani të të gjithë Izraelit: "Qofsh i fortë dhe trim, sepse ti do të hysh bashkë me këtë popull në vendin që ZOTI u betua t'u japë etërve të tyre, dhe ti do t'ua japësh atyre si trashëgimi. Përveç kësaj ZOTI vetë ecën para teje; Ai do të jetë me ty; nuk do të të lërë dhe s'ka për të të braktisur; mos u tremb dhe mos u tmerro". Ligji i Përtërirë 31:7-8

Një drejtues është i gatshëm të ndërmarrë veprime me besim

Një drejtues është i gatshëm të ndërmarrë rreziqe për të arritur sukses më të madh

Perëndia do të të pajisë dhe do të të japë fuqi.

Shembull: **Davidi** (beteja me Goliathin – 1 Samuelit 17)

8. Një drejtues efektiv duhet të jetë**Besues**.

“Ki Besim tek ZOTI me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde”.
Fjalët e Urta 3:5

Një drejtues ka besim te Perëndia, i vetmi që është besnik dhe i vërtetë.

Një drejtues i beson Perëndisë kur rrethanat nuk janë të favorshme.

Shembull: **Abrahami** (flijimi i Isakut – Zanafilla 22)

9. Një drejtues efektiv duhet të jetë**i Përgatitur**.

“Prediko fjalën, ngul këmbë me kohë e pa kohë, bind dhe qorto dhe këshillo me çdo zemërgjerësi e mësim”. 2 Timoteut 4:2

Përgatitja kërkon sakrificë dhe planifikim të mëparshëm

Suksesi është 1% frymëzim dhe 99% përgatitje.

Shembull: **Jozefi** (i përgatitur për zinë e bukës – Zanafilla 41)

10. Një drejtues efektiv duhet të**shfrytëzojë mundësitë**.

“Le të mos ligështohemi duke bërë të mirën; sepse, po të mos ligështohemi, do të korrim në kohën e vet. Prandaj, si të kemi kohë, le t'u bëjmë të mirën të gjithëve, por më shumë atyre që janë pjesëtarë të shtëpisë së besimit”.
Galatasve 6:9-10

Kapeni kohën (shfrytëzoni mundësitë që ju jep Perëndia sot)

Jini vigjilent për ato mundësi.

Shembull: **Esteri** (shpëtoi popullin e saj nga shkatërrimi – Esteri 4)

II. Sfidat e drejtimit

“Por edhe të gjithë ata që duan të rrojnë me perëndishmëri në Krishtin Jezus, do të përndiqen”.

2 Timoteut 3:12

Drejtimi ka aspektet e tij sfiduese:

A. Në krye mund të ketë vetëm një drejtues

1. Jini të mençur
2. Jini të drejtë
3. Jini të vendosur

B. Jo që të gjithë do të bien dakord me ju gjithnjë

1. Prisni që vendimet tuaja të përballen me sfida
2. Njerëzit kanë pikëpamje të ndryshme për çështje të ndryshme
3. Jini në gjendje të mbron vendimin tuaj me arsye dhe me Shkrimin, jo me emocione

C. Është e lehtë të fitoni betejë, por të humbni luftën

1. Mos harroni vizionin tuaj afatgjatë në përpjekje për të arritur qëllimet afatshkurtra
2. Jepuni përparësi gjërave të rëndësishme
3. Jini fleksibël, por asnjëherë mos braktisni parimet tuaja

Vetëvlerësimi i drejtimit

Udhëzime: Jepini pikë vetes për secilin tipar sipas mënyrës vijuese të matjes:

1=Rrallë 2=Nganjëherë 3=Shpesh 4=Zakonisht 5=Gjithmonë

Tipari

Pikët

1. Vizionar	_____
2. I prirur për mision	_____
3. I pasionuar	_____
4. I udhëhequr nga Fryma	_____
5. Shërbëtor	_____
6. I fokusuar	_____
7. Trim	_____
8. Besues	_____
9. I përgatitur	_____
10. Shfrytëzon mundësitë	_____
Totali	_____

Pikët totale

Domethënia e rezultatit

40+	Ke aftësi të mëdha drejtuese. Perëndia mund të të përdorë me dobi!
30-39	Ke disa aftësi drejtuese, por ka ende vend për përmirësim.
20-29	Herë pas here ke shfaqur aftësi drejtuese, por ke nevojë të rritesh në disa fusha.
10-19	Ke aftësi të dobëta drejtuese. Ke nevojë për shumë trajnim dhe përmirësim.
0-9	Nuk shfaq asnjë aftësi drejtuese. Ose kërko trajnim, ose ndiq një thirrje tjetër.

Kapitulli 3

Stilet e drejtimit

“Dhe Ai dha disa si apostuj, të tjerë si profetë, të tjerë si ungjilltarë, të tjerë si barinj e mësues, për ndreqjen e shenjtoreve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit”.

Efesianëve 4:11-12

Perëndia e ka thirrur çdo drejtues që të drejtojë sipas aftësive të tij për përgatitjen e popullit të Perëndisë për veprat e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit. Megjithëkëtë, **si** mund të drejtojë secili është çështje stili dhe komoditeti personal. Si drejtues, ne zakonisht drejtojmë, menaxhojmë dhe veprojmë në një mënyrë që i përshtatet personalitetit, dhuntive dhe përvojave tona. Në disa rrethana mënyra se si drejtojmë mund të jetë shumë efektive, ndërsa në rrethana të tjera mund të jetë jo efektive. Si rrjedhojë, kuptimi i stilit tonë të drejtimit dhe i stileve të të tjerëve mund të na ndihmojë të jemi më të efektshëm në mënyrën se si i zbatojmë aftësitë tona drejtuese në situata të ndryshme. Në këtë kapitull do të shikojmë 4 stile kryesore të drejtimit dhe si mund të përdoren e të zbatohen për një efektivitet maksimal.

I. Cilat janë stilet e drejtimit?

Ka 4 stile drejtimi, sipas Xhorxh Barna (George Barna) në librin e tij *“A Fish Out Of Water”* (*“Peshk pa ujë”*) (Integrity Publishers, 2002)

1. Drejtuesi **udhëheqës**

Ky tip drejtuesi është në mënyrë tipike një person vizionar
Ky tip drejtuesi fokusohet te rezultatet, jo te detajet

2. Drejtuesi **strategjik**

Ky tip drejtuesi pëlqen të analizojë informacionin dhe të vlerësojë
skenarë të ndryshëm
Ky tip drejtuesi pëlqen të zhvillojë dhe të formojë plane për vizionin

3. Drejtuesi i **ndërtimit të skuadrës**

Ky tip drejtuesi është më i interesuar për marrëdhëniet njerëzore
dhe përfshirjen e njerëzve sesa për detyrat
Ky tip drejtuesi pëlqen t’i organizojë njerëz për të arritur vizionin

4. Drejtuesi **operacional**

Ky tip drejtuesi zhvillon procese për të zbatuar vizionin
Ky tip drejtuesi pëlqen të krijojë sisteme dhe të monitorojë rezultatet

II. Përcaktimi i stilit tuaj të drejtimit

Cili është stili juaj i drejtimit?

Më poshtë është një listë pohimesh për sjelljen drejtuese. Lexojeni me kujdes secilin e më pas, duke përdorur shkallën e mëposhtme vlerësuese, përcaktoni se sa kjo zbatohet aktualisht për ju. Për rezultate më të sakta, përgjigjuni sa më me vërtetësi të jetë e mundur.

- | asnjëherë
0 | rrallë
1 | nganjëherë
2 | shpesh
3 | zakonisht
4 | gjithnjë
5 |
|----------------|-------------|-----------------|-------------|----------------|---------------|
|----------------|-------------|-----------------|-------------|----------------|---------------|
- _____ E inkurajoj skuadrën time të marrë pjesë në vendim marrje dhe përpqem t'i vë në praktikë idetë dhe sugjerimet e tyre.
 - _____ Asgjë nuk është më e rëndësishme sesa përmbushja e një qëllimi ose detyre.
 - _____ Respekti dhe vlerësimi për njerëzit është përparësia ime më e madhe.
 - _____ Monitoroj nga afër planin për t'u siguruar që një detyrë ose projekt do të përfundohet në kohë.
 - _____ Më pëlqen t'i përgatis njerëzit për detyra dhe procedura të reja.
 - _____ Sa më sfiduese të jetë një detyrë, aq më shumë më jep kënaqësi.
 - _____ I inkurajoj të tjerët të jenë krijues në punën e tyre.
 - _____ Kur kujdesem që të përfundohet një detyrë komplekse, sigurohem që të jem në dijeni të statusit të çdo detaji.
 - _____ Më pëlqen të lexoj artikuj, libra dhe revista për trajnim, drejtim dhe psikologji; dhe më pas atë që kam lexuar ta zbatoj në praktikë.
 - _____ E kam të lehtë të kryej disa detyra të komplikuara në të njëjtën kohë.
 - _____ Kur korrigjoj gabimet e të tjerëve, shqetësohem se mos rrezikoj marrëdhëniet.
 - _____ E menaxhoj kohën time me shumë efektivitet.
 - _____ Më pëlqen t'ua shpjegoj ndërlikimet dhe detajet e një detyre ose projekti kompleks njerëzve që drejtoj.
 - _____ Më vjen natyrshëm t'i ndaj projektet e mëdha në detyra më të vogla dhe më të menaxhueshme.
 - _____ Nuk ka asgjë më të rëndësishme sesa ndërtimi i një skuadre të mirë.
 - _____ Më pëlqen t'i analizoj problemet.
 - _____ Respektoj kufijtë e të tjerëve.
 - _____ Më pëlqen të lexoj artikuj dhe libra për shërbesë; dhe më pas t'i zbatoj procedurat e reja që kam mësuar.
 - _____ Më vjen natyrshëm t'i këshilloj të tjerët për të përmirësuar rendimentin e tyre.
 - _____ Më pëlqen të organizoj dhe të planifikoj aktivitete.

Seksioni i pikëve

Pas plotësimit të pyetësorit, transferojini përgjigjet tuaja në hapësirat e mëposhtme:

Njerëzit

Pyetja

1. _____
3. _____
5. _____
7. _____
9. _____
11. _____
13. _____
15. _____
17. _____
19. _____

TOTALI _____

(pjesëtojeni përgjigjen me 10 dhe
më pas shumëzojeni me 2)

Pikët: _____

Detyra

Pyetja

2. _____
4. _____
6. _____
8. _____
10. _____
12. _____
14. _____
16. _____
18. _____
20. _____


TOTALI _____

(pjesëtojeni përgjigjen me 10 dhe
më pas shumëzojeni me 2)

Pikët: _____

Seksioni i rezultateve

Vendosini pikët tuaja përfundimtare në grafikun e mëposhtëm, duke shënuar një pikë për rezultatin tuaj e njerëzve tuaj në boshtin vertikal në të djathtë të matricës dhe duke shënuar me një pikë rezultatin tuaj për detyrat në boshtin horizontal në fund të matricës. Më pas vizatoni dy vija të drejta nga secila pikë derisa sa të ndërpriten me njëra-tjetrën. Zona ku ndërpriten është dimensionin e drejtimit nga i cili ju veproni.



III. Zbatimi i stileve të drejtimit

1. Sipas Xhorxh Barnës, secili drejtues ka prirjen të jetë mbizotërues në një nga këto stile. Megjithatë, çdo drejtues ka disa aspekte të secilit stil.

2. Rrethojeni veten me drejtues që kanë stile të tjera drejtimi

Ata do t'ju plotësojnë

Ata do t'i shikojnë gjërat në një mënyrë që ju nuk i shihni

“Planet dështojnë ku nuk ka këshillë, por realizohen atje ku ka një mori këshilltarësh”.

- Fjalët e Urta 15:22

3. Drejtoni në atë fushë ku jeni më të fortë, jo aty ku jeni më dobët

“Dhe duke pasur dhunti të ndryshme sipas hirit që na u dha, nëse kemi profecinë, të profetizojmë sipas masës së besimit. Nëse kemi shërbim, le t'i kushtohemi shërbimit; po kështu mësuesi le të jepet pas mësimit; dhe ai që këshillon, le t'i kushtohet këshillimit; ai që ndan le ta bëjë me thjeshtësi; ai që kryeson le të kryesojë me zell; ai që bën vepra mëshire, le t'i bëjë me gëzim”. – Romakëve 12:6-8

4. Kini parasysh se drejtimi mund të varet nga situatat

Stili juaj mbizotërues nuk do të jetë efektiv në **çdo** situatë

Përcaktoni se cili stil drejtimi do të jetë më efektiv për një rrethanë të dhënë

Shembuj:

1. Përcaktimi i një orientimi të ri për shërbesën tuaj – **Drejtimi udhëzues (kur nevojitet veprim)**
2. Zhvillimi i planeve për shërbesën tuaj – **Drejtimi strategjik (kur nevojitet analizë dhe planifikim)**
3. Zgjidhja e konflikteve në shërbesën tuaj – **Drejtimi i ndërtimit të skuadrës (kur nevojitet puna me njerëz)**
4. Përdorimi i teknologjisë në shërbesën tuaj – **Drejtimi operacional (kur nevojiten sisteme dhe procese)**

Konsideroni mundësinë që të lejoni një drejtues tjetër me stilin drejtues më efektiv në skuadrën tuaj të drejtojë

- Ju keni autoritetin përfundimtar
- Ju ia delegoni projektet/detyrat drejtuese një drejtuesi tjetër në skuadrën tuaj

5. Zbatimi i stilit të gabuar të drejtimit në një rrethanë ka pasoja

Drejtimi juaj mund të kundërshtohet

Mund të dëmtoni besueshmërinë tuaj

Mund të shkaktoni konflikt të padëshiruar
Shërbesa mund të ndalojë së zhvilluari ose të ketë vështirësi

Ushtrim për stilet e drejtimit

Udhëzime: Për secilën situatë të renditur në kolonën në të majtë, shkruani stilin/stilet e duhura të drejtimit që duhet ose mund të përdoren (Udhëzues, strategjik, ndërtues skuadre, operacional):

Situata	Stili/et e drejtimit që mund të zbatoni
1. Ju është ofruar një kompjuter për kishën tuaj dhe duhet të përcaktoni se si ta shfrytëzoni sa më mirë atë	
2. Po filloni një shërbesë burgu dhe nuk doni që t'ju marrë burimet nga shërbesa të tjera	
3. Grupi juaj i adhurimit ka ardhur te ju me ankesa për drejtuesin e adhurimit	
4. E dini se doni që të bëni më shumë për të arritur njerëz në komunitetin tuaj, por nuk jeni të sigurt se si mund ta bëni më mirë këtë	
5. Doni ta transferoni kishën tuaj në një vend të ri e më të madh që ndodhet në anën tjetër të qytetit	
6. Disa njerëz janë ankuar për shërbesën e adhurimit dhe duan që të konsideroni mundësinë për të bërë diçka ndryshe	
7. Shërbesa e fëmijëve nuk po arrin synimet e saj dhe numri i pjesëmarrësve sa vjen e pakësohet	
8. Njerëzit kanë filluar të largohen nga kisha juaj për të shkuar në një kishë të re aty pranë	
9. Një kishë tjetër në qytet ka pyetur nëse mund të përdorin ndërtesën tuaj për të zhvilluar aktivitetet e tyre	
10. Ka një problem thashethemesh në kishën tuaj.	

Kapitulli 4

Zhvillimi i drejtuesve

“Atëherë ZOTI i tha Moisiut: "Merr Jozueun, djalë të Nunit, njeriun në të cilin është Fryma, dhe vër dorën tënde mbi të; pastaj do ta paraqitësh para priftit Eleazar dhe para tërë asamblesë dhe do t'i japësh disa urdhra në prani të tyre, dhe do ta bësh pjesëmarrës të autoritetit tënd me qëllim që tërë asambleja e bijve të Izraelit t'i bindet””.

Numrat 27:18-20

Me drejtimin e kishës ose të shërbesës vjen një përgjegjësi e madhe për kryerjen e punës së shërbesës për të cilën na ka thirrur Zoti. Zakonisht, e marrim si të mirëqenë se si drejtues ne duhet të përfshihemi nga afër në çdo aspekt të shërbesës, me qëllim që të drejtojmë efektivisht. Por e vërteta është se nuk mundemi ta bëjmë një gjë të tillë. Nuk mund të drejtojmë çdo takim, të mbikëqyrim çdo detaj ose të marrim çdo vendim. Nëse duam që të arrijmë synimet tona, ne si drejtues duhet të vëmë në shërbim mbështetjen dhe aftësitë e të tjerëve. Kjo do të thotë se duhet të identifikojmë njerëz të tjerë që janë drejtues potencialë dhe t'i zhvillojmë ata që të mund të drejtojnë, të veprojnë dhe të menaxhojnë sipas qëllimeve dhe autoritetit tonë. Ashtu si Moisiu vuri duart mbi Jozueun, edhe ju keni nevojë të identifikoni drejtues të tjerë, të cilët janë “në frymë” dhe t'i autorizoni të veprojnë në emrin tuaj dhe me autoritetin tuaj. Në këtë kapitull do të rishikojmë se çfarë është një drejtues, pse është e rëndësishme që të zhvillojmë drejtues dhe si t'i identifikojmë dhe t'i zhvillojmë ata.

I. Kush është drejtues?

Sipas Biblës, një drejtues...

1. E njeh identitetin e tij/e saj në Krishtin (**2 Korintasve 5:15-21**)
 - a. E di që jemi të gjithë shërbëtorë për Krishtin (**1 Pjetrit 2:9**)
 - b. Ai na ka pajisur me fuqinë e Tij (**Efesianëve 1:18-20; 3:14-20**)
 - c. Jemi që të gjithë të rëndësishëm për Trupin (**1 Korintasve 12:27**)
2. Kupton dhuntinë frymërore
 - a. Ai i ka dhënë secilit dhunti frymërore. (**1 Korintasve 12:7**)
 - b. Të gjithë jemi thirrur për të përdorur dhuntitë tona. (**Efesianëve 4:11-13**)
 - c. Një drejtues është përgjegjës për t'i nxitur të tjerët të përdorin dhuntitë e tyre. (**2 Timoteut 2:2**)
3. E kupton se puna e tij është të jetë Kripë dhe Dritë. (**Mateu 5:13-16**)
 - a. Duhet të jemi ndikues në kulturën tonë (**Kolosianëve 4:5-6**)
 - b. Jemi shembuj (**1 Thesalonikasve 1:7**)
 - c. Jemi ambasadorë (**2 Korintasve 5:20**)
4. Është i përkushtuar për të përhapur ungjillin (**Veprat e Apostujve 1:8**) dhe për të bërë dishepuj për Krishtin. (**Mateu 28:19**)

II. Pse është kaq e rëndësishme të zhvillojmë drejtues të tjerë?

1. Kjo është mënyra se si rritet mbretëria e Perëndisë

Jezusi mësoi parimin e shumëfishimit të shërbesës përmes dishepujve të Tij

- Jezusi i zgjodhi me kujdes drejtuesit që do të ndërtonin kishën e Tij në tokë
- Jezusit iu desh t'i dishepullizonte dhe t'i pajiste të gjithë ata
- Ai u tha atyre: ***“Shkoni dhe bëni dishepuj të gjitha kombet”***. – Mateu 28:19

Jezusi nuk e ndërtoi kishën krejt i vetëm

“Sikurse më ka dërguar Mua Ati, ashtu Unë po ju dërgoj ju”. - Gjoni 20:21

- Pali shkoi në shumë udhëtime misionare
- Dishepuj dhe ndjekës të tjerë themeluan kisha

Kisha është Një Trup i vetëm dhe secili duhet të bëjë pjesën e vet

“Dhe ju jeni trupi i Krishtit dhe gjymtyrët e Tij veç e veç”.

- 1 Korintasve 12:27

2. Shumëfishon shërbesën tuaj

Bën të mundur që ta shtrini shërbesën tuaj te më shumë njerëz

- Shërbesa juaj mund të ndikojë më shumë jetë
- Shërbesa juaj mund të arrijë më tepër

Ju ndihmon të arrini më shumë, me më pak përpjekje dhe kohë

- Nuk mund të jeni kudo
- Nuk mund të bëni çdo gjë vetë gjithnjë

“Nuk është mirë për ne të lëmë fjalën e Perëndisë për të shërbyer në tryeza”.

– Veprat e Apostujve 6:2

Krijon mundësi të tjera që ju nuk mund t'i dalloni ose nuk jeni në gjendje t'i ndiqni

- Drejtues të tjerë kanë dhunti të tjera për të ndarë
- Drejtues të tjerë kanë pasione dhe interesa të tjera

3. Lejon që Fryma e Shenjtë të veprojë brenda kishës suaj

Fryma e Shenjtë vepron përmes ***të gjithë*** njerëzve, jo vetëm përmes pastorëve

- Ne jemi priftëria e ***të gjithë*** besimtarëve

“Sepse të gjithë ne jemi pagëzuar në një Frymë të vetëm në një trup, qofshin hebrenj apo grekë, skllëvër a të lirë, dhe të gjithë jemi ujitur në një Frymë”. – 1 Korintasve 12:13

- Fryma e Shenjtë fuqizon ***të gjithë*** besimtarët

“Por do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju”.

- Veprat e Apostujve 1:8

4. Suksesi i shërbesës përparon dhe bie nga drejtimi dhe Fryma e Shenjtë

Pa drejtim të fortë një shërbesë nuk mund të ketë sukses

- Drejtuesit e mirë mund t'i rigjallërojnë shërbesat e dobëta
- Drejtuesit jo të mirë mund të shkatërrojnë shërbesa të suksesshme

Fryma e Shenjtë **ËSHTË** burimi i fuqisë sonë

- Ne jemi thjesht mbjellës

“Kështu, pra, as ai që mbjell, as ai që ujit, nuk është gjë, por Perëndia që rrit”. - 1 Korintasve 3:7

- Fuqia jonë vjen nga Perëndia, Fryma e Shenjtë

“Pa Perëndinë nuk mund të bëjmë asgjë”. – Gjoni 15:5

IV. Si i identifikoni drejtuesit e tjerë?

1. Kriteret për drejtues të fortë

Njerëz me karakter

“Duhet, pra, që peshkopi të jetë i paqortueshëm, burrë i një gruaje të vetme, të jetë i kthjellët, i arsyeshëm, i ndershëm, mikpritës, i aftë të japë mësim, të mos jepet pas verës, të mos jetë i dhunshëm, të mos jetë lakmues i fitimeve të turpshme, por i butë, jo grindavec, të mos dojë paranë”.

- 1 Timoteut 3:2-3

Njerëz me besim

“Ata duhet të mos jenë të posakthyer në besim, që të mos u rritet mendja dhe të bien në gjykimin e djallit”. – 1 Timoteut 3:7

“Ata duhet të ruajnë misterin e besimit me ndërgjegje të pastër”. – 1 Timoteut 3:9

Njerëz të mbushur me Frymën

“Prandaj, vëllezër, kërkon midis jush shtatë burra të mbushur me Frymën e Shenjtë dhe me urtësi”. – Veprat e apostujve 6:3

2. Kriteria për drejtues, të cilat nuk përmenden në Bibël (por që përdoren zakonisht)

Arsimimi

Pozita shoqërore

Përvoja

**** Këto janë gjëra të mira për t'i pasur por NUK duhet të jenë kriteret kryesore**

3. Zgjedhja e drejtuesve

Zgjidhni njerëz me pasion

Zgjidhni njerëz që janë të trajnueshëm

Zgjidhni njerëz që kanë dhuntitë e nevojshme ose të duhura frymërore

V. Si zhvilloni drejtues të tjerë? (referojuni Mateut, Kapitulli 10)

- Hapi Nr. 1: Dishepullizojini ata**
Këshillim javor
Fjalë dhe vepra inkurajimi
Ndërtim besimi
Përgatitje (trajnim drejtuesi)
- Hapi Nr. 2: Delegojuni përgjegjësi (Mateu 10:1)**
Jepuni diçka për ta drejtuar ose për ta menaxhuar
Mbështetini që ta kryejnë punën
Ndërtoni vetëbesimin e tyre
- Hapi Nr. 3: Komunikojuni atyre pritshmëritë tuaja (Mateu 10:6-8, 16)**
Përcaktoni synime të qarta për ta dhe ndihmujini të zhvillojnë një plan drejtimi
Përcaktoni parametra ose direktiva
- Hapi Nr. 4: Mbajini përgjegjës (Mateu 10:32-33)**
Prisni prej tyre që t'i përmbushin qëllimet
Nëse ka probleme mos ndërhyini për t'i rregulluar vetë, lërin ata t'i rregullojnë
Jepni këshilla kur nevojitet
Lejoni që të jenë ata që të gjejnë zgjidhje
- Hapi Nr. 5: Rishikoni progresin e tyre herë pas here**
Takohuni rregullisht për të diskutuar për çështje dhe shqetësime të caktuara
Mos i lini vetëm ose mos i shpërfillni
Tregoni interes për t'i ndihmuar të mësojnë e të jenë të suksesshëm
- Hapi Nr. 6: Dërgojini në shërbesë**
Kur të jenë gati, lërin të shkojnë – mos i frenoni
Jepuni një shërbesë për të drejtuar
Caktojini për punë shërbese

Ushtrim për zhvillimin e drejtuesve

Pranë çdo pozicioni drejtues në shërbesë shkruani dhuntitë frymërore që mendoni se janë të nevojshme dhe aftësitë ose përvojën që mendoni se do të jenë të dobishme për atë pozicion.

Pozicioni i shërbesës	Dhuntitë frymërore**	Aftësi/Përvojë
1. Pastor		
2. Drejtues adhurimi		
3. Drejtues shërbese për fëmijë		
4. Drejtues shërbese për të rinj		
5. Plak		
6. Mësues		
7. Ungjilltar		
8. Misionar		
9. Menaxher financiar		
10. Drejtues shërbese për lutjen		

**** Referojuni listës së Dhuntive Frymërore në faqet 38-39**

Pjesa 2

Menaxhimi i njerëzve



Kapitulli 5

Dhuntitë frymërore

“Dhe secilit i jepet shfaqja e Frymës për dobinë e përbashkët. Dhe të gjitha këto i bën i njëjti dhe i vetmi Frymë, duke i ndarë gjithsecilit dhunti veç e veç, ashtu si do vetë”.

1 Korintasve 12:7, 11

Bibla thotë se çdo të krishteri i është dhënë një (disa) dhunti frymërore për ta përdorur në ndërtimin e Trupit të Krishtit. Por çfarë janë saktësisht dhuntitë frymërore? A janë ato njësor si aftësitë dhe talentet tona? Si e dimë se çfarë dhuntish frymërore kemi? Dhe si e dimë ku dhe si t'i përdorim ato? Këto janë pyetje tipike që i bëjnë shumë të krishterë kur bëhet fjalë për të kuptuar rolin e tyre në kishë ose në Trupin e Krishtit. Si drejtues është e rëndësishme jo vetëm të dish dhuntinë tënde, por dhe dhuntitë e të tjerëve, me qëllim që t'i drejtosh në fusha të shërbesës ku Perëndia mund të përdorë më efektivisht. Në këtë kapitull do të shikojmë se çfarë janë dhuntitë frymërore, pse janë të rëndësishme dhe si duhet të përdoren për ndikim maksimal për mbretërinë. Do të japim dhe një mjet vlerësimi për të ndihmuar të përcaktoni se cila mund të jetë dhuntia(të) juaj frymërore.

I. Çfarë janë dhuntitë frymërore?

Dhuntitë frymërore janë ato aftësi që Fryma e Shenjtë u jep ndjekësve të Krishtit për t'i pajisur për shërbesë.

1. Këto dhunti jepen për dobinë e përbashkët
“Dhe secilit i jepet shfaqja e Frymës për dobinë e përbashkët”. - 1 Korintasve 12:7
2. Këto dhunti jepen ashtu si do Fryma e Shenjtë
“Ai i ndan gjithsecilit, ashtu si do vetë”.- 1 Korintasve 12:11
3. Dhuntitë jepen sipas nevojës

Dhuntitë frymërore ndahen në 3 kategori kryesore

1. Dhunti **shërbese** – zakonisht një thirrje për një pozicion të caktuar
2. Dhunti **praktike** – për t'u shërbyer të tjerëve
3. Dhunti **karizmatike** – shpallja dhe fuqitë frymërore

Bibla përmend 21 dhunti specifike

1. Shërbese

Apostull, profet, ungjilltar, barinj (pastorë), mësues

“Dhe ai dha disa si apostuj, të tjerë si profetë, të tjerë si ungjilltarë, të tjerë si barinj e mësues”. - Efesianëve 4:11

2. Praktike

Shërbim, këshillim, ndarje, drejtim, vepra mëshire, ndihmë, administrim

“Nëse kemi shërbim, le t’i kushtohemi shërbimit; po kështu mësuesi të jepet pas mësimit; dhe ai që këshillon, le t’i kushtohet këshillimit; ai që ndan le ta bëjë me thjeshtësi; ai që kryeson le të kryesojë me zell; ai që bën vepra mëshire, le t’i bëjë me zell”.

- Romakëve 12:7-8

“Dhe Perëndia vuri disa në kishë , së pari apostuj, së dyti profetë, së treti mësues; pastaj dhuntitë e shërimeve, ndihmës, qeverisjes, të larmive të gjuhëve”. - 1 Korintasve 12:28

3. Karizmatike

Urtësi, njohuri, dallim, profeci, gjuhë, interpretim, besim, shërim, mrekulli

“Dikujt, pra, i jepet, fjalë urtësie me anë të Frymës; një tjetri, sipas po atij Fryme fjalë njohurie; një tjetri, besim në po atë Frymë; një tjetri, dhuntinë e shërimeve, në po atë Frymë; një tjetri pushtet për të kryer mrekulli të fuqishme; një tjetri, profeci; një tjetri, të dallojë frymërat; një tjetri larmi gjuhësh; një tjetri interpretimi i gjuhëve”.

- 1 Korintasve 12:8-10

****Ka dhunti të tjera frymërore të përmendura në Bibël, por këto janë ato që janë përcaktuar më qartësisht në Besëlidhjen e Re.**

II. Përse janë të rëndësishme dhuntitë frymërore?

Për të përmbushur qëllimin dhe planin e Perëndisë për njerëzimin

“Perëndia i paqes ... ju bëftë të përsosur për çdo vepër të mirë, që të kryeni vullnetin e Tij....” - Hebrenjve 13:20-21

Për të përgatitur popullin e Perëndisë për vepra shërbimi

“Për ndreqjen e shenjtorëve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit”. - Efesianëve 4:12

Për të arritur pjekuri frymërore

“Derisa të arrijmë të gjithë tek uniteti i besimit dhe i njohjes së Birit të Perëndisë, te një burrë i përsosur”. - Efesianëve 4:13

Për të unifikuar Trupin e Krishtit

“Dhe ju jeni trupi i Krishtit dhe gjymtyrët e Tij, veç e veç”.

- 1 Korintasve 12:27

III. Si duhet të përdoren dhe zbatohen dhuntitë frymërore?

Për ndërtimin e kishës

“Kështu edhe ju, mbasi doni fort të keni dhunti frymërore, kërkonit që t’i keni të bollshme për ndërtimin e kishës”. 1 Korintasve 14:12

Për t’u shërbyer të tjerëve

“Gjithsecili le ta vërë në shërbim të tjetrit dhuntinë që ka marrë, si administratorë të mirë të hirit të shumëfarshëm të Perëndisë”. - 1 Pjetrit 4:10

Për të përlëvduar Perëndinë

“Nëse dikush flet, le ta bëjë si thëniet e Perëndisë; kush bën një shërbim le ta bëjë në forcën që i jep Perëndia, që në gjithçka të përlëvdohet Perëndia nëpërmjet Jezus Krishtit”. - 1 Pjetrit 4:11

Për të shfaqur karakterin e Perëndisë

“Por fryti i Frymës është: dashuria, gëzimi, paqja, zemërgjerësia, mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutësia, vetëpërmbytja”. - Galatasve 5:22

Pali jep dhe 2 paralajmërime:

Ato nuk duhet të lihen pas dore

“Mos e lër pas dore dhuntinë që është në ty, e cila të është dhënë me anë profecie, me vënien e duarve nga pleqësia”. - 1 Timoteut 4:14

Ato duhet të përdoren me rregullsi

“Por të gjitha të bëhen siç ka hije dhe me rregullsi”. - 1 Korintasve 14:40

IV. Vlerësimi i dhuntisë frymërore

Çfarë është?

- Një mjet zbulues që përdor pyetje dhe përgjigje me alternativa
- Një mjet për përcaktimin e dhuntive frymërore të dikujt
- Një udhëzues për t’i ndihmuar njerëzit të gjejnë rolin e tyre në kishë

Çfarë nuk është

- Nuk është absolut. Dhuntitë mund të ndryshojnë me kalimin e kohës
- Nuk duhet të përdoret asnjëherë për të kufizuar shërbimin ose shërbesën e dikujt. Dhuntitë jepen nga Perëndia kur nevojiten.

Testi i dhuntive frymërore

<http://www.kodachrome.org/spiritgift>

Perëndia ka bekuar çdo njeri me **dhunti frymërore**. A e dini se ç' **dhunti frymërore** ju ka dhënë Perëndia? Nëse keni qenë duke vrarë mendjen se çfarë **dhuntish frymërore** keni, atëherë ky test do t'ju tregojë se cilat mund të jenë ato.

Ky është një test për **dhuntitë frymërore**. Përbëhet nga 110 **pohime**, të cilave do t'u përgjigjeni me: **gjithnjë, zakonisht, shpesh, nganjëherë, rrallë, rrallëherë ose asnjëherë** për të treguar se si ndiheni për atë pohim.

Ju lutem kini parasysh se ky test është përgatitur nga njerëz, jo nga Perëndia, dhe si i tillë sigurisht që nuk është i përsosur. Duhet të përdoret si një pikënisje për të zbuluar **dhuntitë tuaja frymërore**, por sigurisht që nuk duhet të merret si një tregues absolut. Testi jo gjithnjë mund të tregojë **dhuntitë tuaja të vërteta frymërore**. Është vetëm një mjet në procesin që duhet të jetë një kërkim i gjithë jetës suaj se si Perëndia ju ka bekuar që të bekonit të tjerët.

Duhet të kaloni kohë të mjaftueshme për t'ju **përgjigjur TË GJITHA** pohimeve ose përndryshe testi nuk do të japë rezultate kuptimplota.

Përgjigji secilit **pohim** me numrin që i korrespondon ndjenjës së parë që keni sipas shkallës së mëposhtme:

Gjithnjë	= 5
Zakonisht	= 4
Shpesh	= 3
Nganjëherë	= 2
Rrallë	= 1
Asnjëherë	= 0

Le të fillojmë:

- 1) _____ **Njerëzit duket se janë të gatshëm ta ndjekin drejtimin tim pa shumë rezistencë.**
- 2) _____ **Më pëlqen t'ua shpall fjalën e Perëndisë të krishterëve të tjerë.**
- 3) _____ **Për mua është gëzim t'u shpall planin e shpëtimit të Perëndisë njerëzve që nuk shkojnë në kishë.**
- 4) _____ **Është e gëzueshme të kesh përgjegjësinë për të drejtuar të tjerët në jetën e tyre frymërore.**
- 5) _____ **Ngazëllem kur ndihmoj njerëzit për të zbuluar të vërteta të rëndësishme në Shkrim.**
- 6) _____ **Kam gëzim të veçantë t'i këndoj lavde Perëndisë qoftë vetë, qoftë me të tjerë.**
- 7) _____ **Është e pëlqyeshme të nxisësh njerëzit drejt një përkushtimi më të madh frymëror.**

- 8) _____ Me sa duket, njerëz me probleme frymërore vijnë tek unë për udhëzim e këshillim.
- 9) _____ Kam marrë nota të shkëlqyera në shkollë.
- 10) _____ Ka gëzim të madh në kryerjen e punëve të vogla në kishë.
- 11) _____ Shikoj për mundësi si t'i ndihmoj të tjerët në punën e tyre.
- 12) _____ Ka gëzim të madh t'i drejtosh njerëzit të përmbushin qëllimet e grupit.
- 13) _____ Më pëlqen t'i organizoj njerëzit për shërbesë më efektive.
- 14) _____ Ka kënaqësi të madhe në dhënien e shumave të mëdha të parave për punën e Zotit.
- 15) _____ Ndiej dhembshuri të madhe për problemet e të tjerëve.
- 16) _____ Më duket e lehtë të dalloj nëse dikush është i ndershëm ose jo.
- 17) _____ Jam gati të provoj të bëj të pamundurën sepse kam besim të madh te Perëndia.
- 18) _____ Është gëzim i madh të pres njerëz në shtëpi për vizitë.
- 19) _____ Shikoj që riparimi dhe mirëmbajtja e gjërave përreth më vjen ndoresh.
- 20) _____ Më duket se i dalloj nevojat për lutje përpara se të tjerët t'i dallojnë.
- 21) _____ Më pëlqen mundësia për t'u lutur me dikë dhe për dikë që është i sëmurë fizikisht që të shërohet.
- 22) _____ Përshtatem lehtë në një kulturë të ndryshme nga e imja.
- 23) _____ Ndiej një ndjesi autoriteti në marrëdhënien time me grupin.
- 24) _____ Më pëlqen të shpall Fjalën e Zotit për të ngushëlluar të tjerët.
- 25) _____ Duket se mund ta dalloj kur Fryma ka përgatitur dikë për të pranuar Jezus Krishtin.
- 26) _____ Është ngazëllyese të ofrosh drejtim frymëror për një bashkësi.
- 27) _____ Të jap mësim për Biblën është një nga gjërat më të kënaqshme që bëj (ose që mund të bëj) në kishë.
- 28) _____ Perëndia më ka dhënë aftësinë të luaj një instrument muzikor dhe kjo më jep kënaqësi.
- 29) _____ Është gëzim të inkurajoj njerëz që janë të dekurajuar.
- 30) _____ Më pëlqen të gjej zgjidhje për probleme të vështira në jetë.
- 31) _____ Më duket se kam të lehtë të mësoj të vërteta që janë të vështira.
- 32) _____ Më pëlqen të bëj detyra rutinë për lavdinë e Perëndisë.
- 33) _____ Kam kënaqësi të ndihmoj me detyra urgjente në kishë.
- 34) _____ Duket se njerëzve u pëlqen të më ndjekin në kryerjen e një detyre të rëndësishme.
- 35) _____ Ka gëzim në marrjen e vendimeve të rëndësishme.
- 36) _____ Gjej gëzim të vërtetë në dhënien e një pjese bujare të parave të mia për Zotin.
- 37) _____ Vizitat te njerëzit në azile më japin shumë kënaqësi.
- 38) _____ Duket se e kuptoj shumë shpejt nëse diçka është e drejtë apo e gabuar.
- 39) _____ Kur gjërat duken të pamundura, jam gati të vazhdoj përpara.
- 40) _____ Nuk kam ndonjë ndjesi parehatie kur njerëzit vijnë papritur për vizitë.
- 41) _____ Më ka pëlqyer të merrem me art dhe/ose të bëj lloje të ndryshme punëdore.
- 42) _____ Lutja është një nga ushtrimet e mia të preferuara frymërore.
- 43) _____ Jam lutur për dikë të sëmurë emocionalisht dhe e kam parë të

- përmirësohet.
- 44) _____ Është e lehtë për mua të transferohem në një komunitet të ri dhe të zë miq.
 - 45) _____ Nuk kam frikë t'i drejtoj njerëzit aty ku Perëndia do që të shkojnë.
 - 46) _____ Më pëlqen ta lidh Fjalën e Perëndisë me çështjet e ditës dhe ta ndaj atë me të tjerët.
 - 47) _____ Kam ndjesinë e një barre se duhet ta ndaj ungjillin me njerëzit.
 - 48) _____ Më pëlqen t'i ndihmoj njerëzit me problemet e tyre frymërore.
 - 49) _____ Duket që njerëzit mësojnë kur unë u jap mësim.
 - 50) _____ Më ka pëlqyer të jem i përfshirë në shfaqjet muzikore lokale, të kishës, ose të shkollës.
 - 51) _____ Më pëlqen të inkurajoj anëtarë jo aktivë të kishës që të bëhen përsëri të krishterë të përfshirë.
 - 52) _____ Duket se në përgjithësi njerëzit e ndjekin këshillën time.
 - 53) _____ Jam në gjendje të kuptoj pjesë të vështira të fjalës së Perëndisë.
 - 54) _____ Marr kënaqësi të madhe në bërjen e detyrave të vogla ose të parëndësishme në kishë.
 - 55) _____ Dëshiroj të bëj detyra që do t'i lironin të tjerët për shërbesë të rëndësishme.
 - 56) _____ Është më efektive ta delegoj një detyrë sesa ta bëj vetë.
 - 57) _____ Më pëlqen përgjegjësia për arritjen e qëllimeve të grupit.
 - 58) _____ Vlerësoj mundësinë për të mbështetur financiarisht një situatë kritike.
 - 59) _____ Ndiej gëzim në ngushëllimin e njerëzve në situata të vështira.
 - 60) _____ Ndryshimi midis së vërtetës dhe gabimit dallohet lehtë prej meje.
 - 61) _____ Shpesh jam gati të besoj se Perëndia do të na drejtojë përmes një situatë, ndërkohë që të tjerët mendojnë se është e pamundur.
 - 62) _____ Duket se njerëzit ndihen shumë rehat në shtëpinë time.
 - 63) _____ Më pëlqen të krijoj gjëra me duart e mia.
 - 64) _____ Perëndia u përgjigjet lutjeve të mia vazhdimisht në mënyra të prekshme.
 - 65) _____ Kam vizituar dikë që ishte sëmurë, u luta që Perëndia ta shëronte fizikisht dhe u bë më mirë.
 - 66) _____ Mund të shoqërohem më së miri me të krishterë nga vende e kultura të ndryshme.
 - 67) _____ E vlerësoj mundësinë për t'u shpallur fjalën e Perëndisë të tjerëve.
 - 68) _____ Për mua është e rëndësishme të flas për paralajmërimin dhe gjykimin e fjalës së Perëndisë sot në botë.
 - 69) _____ Është gëzim të ndaj atë që Jezusi është për mua me një fqinj që nuk shkon në kishë.
 - 70) _____ Njerëzve u pëlqen të flasin me mua për shqetësimet dhe merakun e tyre, sepse e ndiejnë që interesohem për ta.
 - 71) _____ Një nga gëzimet e shërbesës sime është trajnimi i njerëzve për të qenë të krishterë më efektivë.
 - 72) _____ Ndihem i sigurt në faktin se aftësia ime muzikore do të jetë në dobi të të tjerëve me të cilët bie në kontakt.
 - 73) _____ Njerëzit që ndihen të pështjelluar shpesh vijnë tek unë për inkurajim e ngushëllim.
 - 74) _____ Ndiej që kam një mprehtësi të veçantë për të zgjedhur mundësisë më të mirë në një situatë të vështirë.

- 75) _____ Kam një të kuptuar të qartë të doktrineve (mësimeve) biblike.
- 76) _____ Gjej më shumë kënaqësi ta bëj vetë një punë, sesa të gjej dikë tjetër për ta bërë atë.
- 77) _____ Vlerësoj një shërbesë që ndihmon të tjerët të mbajnë barrët e tyre.
- 78) _____ Është kënaqësi të frymëzosh të tjerët për t'u përfshirë më shumë në punën e kishës.
- 79) _____ Zhvillimi i planeve efektive për shërbesën e kishës më jep kënaqësi të madhe.
- 80) _____ Është gëzim të shikoj se sa shumë para mund të jap për Zotin.
- 81) _____ Më pëlqen t'i shërbej në personi që është i sëmurë në spital.
- 82) _____ Mund të gjej mirë midis vërtetësisë dhe gabimit të një pohimi të caktuar teologjik.
- 83) _____ Duket se njerëzit më shohin si dikë që beson se çdo gjë është e mundur.
- 84) _____ Kur vij në misionarë në kishën tonë më pëlqen të vij në shtëpinë time.
- 85) _____ Shikoj se rezultatet e punës sime me sende të ndryshme të krijimit të Perëndisë ndihmojnë për të përmirësuar dhe zbukuruar atë që njerëz të tjerë nuk e kanë parë apo krijuar.
- 86) _____ Lutem besnikërisht për të tjerët që të pranojnë se efektiviteti dhe mirëqenia e tyre totale varet në përgjigjen e Perëndisë ndaj lutjeve.
- 87) _____ Më pëlqen të marr pjesë në shërbesë me të sëmurë fizikisht dhe emocionalisht dhe të lutem për shërimin e tyre.
- 88) _____ Është ngazëllyese kur mendoj të filloj një kishë të re në një komunitet të ri.
- 89) _____ Më pëlqen të trajtoj punëtorë në kishë.
- 90) _____ Më duket thelbësore në një kurs bible që të ndaj fjalën e Perëndisë edhe pse kjo gjë i nxeh të tjerët.
- 91) _____ Ndiej një shqetësim të thellë për njerëzit e paarritur në komunitetin tim.
- 92) _____ Më pëlqen një marrëdhënie e afërt me njerëz në një situatë një për një.
- 93) _____ Është e lehtë të organizosh materiale për të dhënë mësim në një kurs Bible.
- 94) _____ Është kënaqësi për mua t'i drejtoj të tjerët të këndojnë këngë lavdërimi për Perëndinë ose të këndojnë vetëm për qejf.
- 95) _____ Më mirë do t'i kërkoja ndihmë një familjeje ligj shkelëse në kishën time sesa një familjeje që nuk shkon në kishë.
- 96) _____ Kam një ndjenjë të fortë vetëbesimi në zgjidhjen që u jap problemeve.
- 97) _____ Të lexoj dhe të studioj një libër të vështirë të Biblës është një sfidë ngazëlluese.
- 98) _____ Më pëlqen t'i bëj gjërat pa tërhequr shumë vëmendje.
- 99) _____ Më pëlqen mundësia të ndihmoj, nëse një familje është përballë një krize serioze.
- 100) _____ Kur të tjerët më ndjekin në kryerjen e një detyre, ndiej kënaqësi të madhe.
- 101) _____ Më mirë do të merrja vendime për grupin sesa t'i bindja ata të merrnin të njëjtin vendim.
- 102) _____ Mund të jap në mënyrë sakrifikuese sepse e di që Perëndia do t'i plotësojë nevojat e mia.

- 103) _____ Të vizitoj njerëz që e kanë të pamundur të dalin nga shtëpitë e tyre më jep kënaqësi të veçantë.
- 104) _____ Shpesh kërkoj shkaqet e një personi dhe shikoj përtej fjalëve që thuhet.
- 105) _____ Më pëlqen t'ju jap njerëzve një vizion pozitiv kur janë të dekurajuar.
- 106) _____ Duket se njerëzve u pëlqen të vijnë në shtëpinë time.
- 107) _____ Ka kënaqësi në vizatimin, skicimin dhe/ose të pikturoj sende të ndryshme.
- 108) _____ Kur me shumë mundësi duhet të jem duke bërë gjëra të tjera, e gjej veten të lutem
- 109) _____ Ndihej i sigurt se lutjet e mia për dikë të sëmurë ndikojnë shëndetin e tij.
- 110) _____ Më shumë herë se jo, kam dëshirë të fortë t'i shoh të gjithë njerëzit e komuniteteve dhe të vendeve të tjera të fituar për Zotin.

Përgëzime, keni përfunduar **testin e vlerësimit të dhuntive frymërore!**

Ju lutem harxhoni një minutë për t'i parë shpejt të gjitha **pohimet** se mos keni harruar t'i përgjigjeni ndonjërit prej tyre.

Tani transferojini **përgjigjet** tuaja në **fletë analizën**. Për ta bërë këtë, duhet të shikoni përgjigjen tuaj për çdo pyetje.

Për secilën nga të 110 **pyetjet**, shkruani përgjigjen numerike në kutinë përkatëse të **fletë analizës**. Më pas mbliidhni secilën kolonë horizontale të numrave që shkruat dhe vendosni shumën në kutinë e **totalit**. Këtu keni një shembull të shkurtër:

P#	Përgj.	P#	Përgj.	P#	Përgj.	P#	Përgj.	P#	Përgj.	Totali	Renditja	Dhuntia frymërore
1	1	23	3	45	0	67	1	89	3	8	2	Apostull
2	3	24	1	46	1	68	0	90	1	6	3	Profet
3	3	25	5	47	3	69	5	91	1	17	1	Ungjilltar

Tani, shikoni të gjitha **totalet**. **Dhuntia frymërore** që është më e fortë në ju, me shumë mundësi është **Totali** me shumën më të lartë. Disa njerëz do të kenë disa **dhunti frymërore** me të njëjtën shumë të **totalit**. Testi i vlerësimit nuk është i përsosur, kështu që **dhuntia juaj frymërore** më e fortë mund të mos tregojë shumën e **totalit** më të lartë. Në fund do të gjeni një **listë të dhuntive frymërore** duke dhënë një referencë Shkrimi për secilën.

Ky test i dhuntive frymërore mund të gjendet në internet në

<http://www.kodachrome.org/spiritgift>

Fletë analiza e dhuntive frymërore

MOS e shikoni këtë fletë DERISA të keni përfunduar testin tuaj

P#	Përgj.	P#	Përgj.	Q#	Përgj.	P#	Përgj.	P#	Përgj.	Totali	Renditja	Dhuntia frymërore
1		23		45		67		89				Apostull
2		24		46		68		90				Profet
3		25		47		69		91				Ungjillëzues
4		26		48		70		92				Pastor
5		27		49		71		93				Mësues
6		28		50		72		94				Muzikë
7		29		51		73		95				Këshillim
8		30		52		74		96				Urtësi
9		31		53		75		97				Njohuri
10		32		54		76		98				Shërbim
11		33		55		77		99				Ndihmë
12		34		56		78		100				Drejtëm
13		35		57		79		101				Administrim
14		36		58		80		102				Dhënie
15		37		59		81		103				Mëshirë
16		38		60		82		104				Dallim
17		39		61		83		105				Besim
18		40		62		84		106				Mikpritje
19		41		63		85		107				Zejtari
20		42		64		86		108				Ndërhyrje
21		43		65		87		109				Shërim
22		44		66		88		110				Misionar

Lista e dhuntive frymërore

Apostull

Është dhuntia me anë të së cilës Fryma cakton disa të krishterë t'i drejtojnë, t'i frymëzojnë dhe t'i zhvillojnë kishat e Perëndisë me anë të shpalljes dhe të mësimi të doktrinës së vërtetë. Shih [Veprat e Apostujve 12:1-5](#), [Veprat e Apostujve 14:21-23](#).

Profet

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma fuqizon disa të krishterë të interpretojnë dhe të zbatojnë zbulesën e Perëndisë në një situatë të caktuar. Shih [1 Korintasve 14:1-5](#), [1 Korintasve 14:30-33](#), [1 Korintasve 14:37](#).

Ungjilltar

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma i mundëson të krishterëve të veçantë të ndajnë ungjillin me jobesimtarët në një mënyrë të tillë që një jobesimtar bëhet dishepull i Zotit Jezus. Shih [Veprat e Apostujve 8:26-40](#).

Pastor

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma i mundëson disa të krishterë të marrin përgjegjësinë për mirëqenien frymërore e një grupi besimtarësh. Shih [1 Pjetrit 5:1-11](#).

Mësues

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson të krishterë të veçantë të komunikojnë të vërtetat e fjalës së Perëndisë me qëllim që të tjerët të mësojnë. Shih [Hebrenjve 5:12-14](#).

Muzikë

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson disa të krishterë të caktuar të lëvdojnë Perëndinë përmes formave të ndryshme muzikore dhe të rrisin përvojën e adhurimit të bashkësisë lokale. Shih [1 Korintasve 14:26](#), [Marku 12:36](#).

Këshillim

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson të krishterë të caktuar t'u qëndrojnë pranë të krishterëve të tjerë në nevojë dhe t'u japin ngushëllim, këshillë dhe inkurajim që ata të ndihen se dikush po i ndihmon. Shih [Veprat e Apostujve 11:23-24](#), [Veprat e Apostujve 14:21-22](#).

Urtësi

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma pajis të krishterë të caktuar me një të kuptuar të vullnetit dhe të punës së Perëndisë që ka të bëjë me të jetuarit e jetës. Shih [Jakobi 3:13-17](#).

Njohuri

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson të krishterë të caktuar të kuptojnë në një mënyrë të jashtëzakonshme të vërtetat e mrekullueshme të Fjalës së Perëndisë dhe t'i bëjë ato të përshtatshme për situata specifike në kishë. Shih [Efesianëve 3:14-19](#).

Shërbim

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma fuqizon të krishterë të caktuar të mbajnë me dëshirë barrët e të krishterëve të tjerë dhe t'i ndihmojnë ata në një mënyrë të tillë që ata të mund t'i kryejnë detyrat e tyre me më shumë efektivitet. Shih [Galatasve 6:1-2](#).

Ndihmë

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma fuqizon të krishterë të caktuar të mbajnë barrët e të krishterëve të tjerë me dëshirë dhe t'i ndihmojnë ata në një mënyrë të tillë që ata të mund t'i kryejnë detyrat e tyre me më shumë efektivitet. Shih [Veprat e Apostujve 6:2-4](#).

Drejtim

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson të krishterë të caktuar të nxisin, drejtojnë dhe të frymëzojnë njerëzit e Perëndisë në një mënyrë të tillë që ata vullnetarisht dhe me harmoni punojnë së bashku për të kryer punën e kishës në mënyrë efektive. Shih [Hebrenjve 13:7](#), [Gjyqtarët 3:10](#), [Eksodi 18:13-16](#).

Administrim

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson të krishterë të caktuar të kuptojnë qëllimet e një pjese të dhënë të shërbesës së kishës dhe për ta drejtuar atë fushë me efektivitet, duke e mbajtur kishën në rrugën e duhur. Shih [Veprat e Apostujve 12:12-21](#).

Dhënie

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson të krishterë të caktuar të ofrojnë bekimet e tyre materiale për punën e kishës me gatishmëri, gëzim dhe bujari të veçantë. Shih [2 Korintasve 8:1-5](#).

Mëshirë

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson të krishterë të caktuar të kenë ndjeshmëri dhe dhembshuri të veçantë për ata që vuajnë me qëllim që ata t'i kushtojnë shumë kohë dhe energji për ta lehtësuar vuajtjen. Shih [Luka 10:30-37](#).

Dallim

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson të krishterë të caktuar të dinë me siguri nëse një sjellje është nga Perëndia apo nga Satani. Shih [Veprat e Apostujve 5:3-6](#), [Veprat e Apostujve 16:16-18](#).

Besim

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma i siguron të krishterë të caktuar me vetëbesim të jashtëzakonshëm në premtimet, fuqinë dhe praninë e Perëndisë me qëllim që ata të mbrojnë heroikisht të ardhmen e veprës së Perëndisë në kishë. Shih [Hebrenjve 11](#).

Mikpritje

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson të krishterë të caktuar të hapin me gëzim shtëpitë e tyre dhe të ofrojnë strehë, ushqim dhe bashkësi me hare për njerëz të tjerë. Shih [Zanafilla 18:1-15](#).

Zejtari

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma pajis të krishterë të caktuar me aftësinë për të përdorur duart dhe mendjet për të ndërtuar Mbretërinë nëpërmjet mënyrave artistike dhe krijuese. Shih [Eksodi 28:3-4](#).

Ndërhyrje

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma mundëson të krishterë të caktuar të lutën për periudha të zgjatura kohore me efekt të madh pozitiv për ndërtimin e Mbretërisë. Shih [1 Thesalonikasve 3:10-13](#), [1Timoteut 2:1-2](#).

Shërim

Është dhuntia e veçantë me anë të së cilës Fryma përdor të krishterë të caktuar për t'u kthyer shëndetin të sëmurëve. Shih [Jakobi 5:13-16](#), [Luka 9:1-2](#).

Misionar

Është dhuntia e veçantë e dhënë nga Fryma e Shenjtë për të krishterë të caktuar të trupit të Krishtit (kisha lokale) për të shërbyer me çfarëdo dhuntish të tjera që kanë në një tjetër kulturë ose komunitet. Shih [1 Korintasve 9:19-23](#).

Kapitulli 6

Menaxhimi i njerëzve

***“Por, ashtu siç dëshironi që t’ju bëjnë juve njerëzit,
edhe ju u bëni atyre njësoj”.***

Luka 6:31

Parimi i artë. Duket se të gjithë e dimë kaq mirë dhe megjithëkëtë shumicën e kohës nuk jemi në gjendje ta zbatojmë. Kisha është aktivitet me njerëz e themeluar në marrëdhënie – me Perëndinë dhe njëri-tjetrin. Jezusi na mësoi këtë parim që të jetojmë në harmoni me njëri-tjetrin dhe me Perëndinë dhe t’i tregojmë botës dashurinë për të cilën Ai vdiq. Kur menaxhoni njerëz, ju jeni në marrëdhënie me ta, nuk jeni vetëm në një pozicion autoriteti mbi ta. Menaxhimi i njerëzve nuk do të thotë t’u thuash të tjerëve çfarë mund të bëjnë për ju, por më shumë t’i pyesni ata se çfarë mund të bëni për ta. Është zbatimi i përditshëm i parimit të artë sikurse na mësoi Jezusi. Në këtë kapitull, do të shikojmë rëndësinë e menaxhimit të njerëzve dhe si t’i menaxhojmë njerëzit.

I. Pse është i rëndësishëm menaxhimi i njerëzve?

1. Thelbi i kishës janë njerëzit

“Por ju jeni fis i zgjedhur, priftëri mbretëror, komb i shenjtë, popull i fituar nga Perëndia, që të shpallni lavdinë e Atij, që ju thirri nga terri në dritën e Tij të mrekullueshme”.

2:9

Kisha nuk është ndërtesë, por përbëhet nga njerëzit

Fokusi ynë është te njerëzit, jo te gjërat

Është e gjitha për marrëdhëniet

- Me Perëndinë
- Me Krishtin
- Me njëri-tjetrin

2. Njerëzit janë burimi më i madh i kishës

Njerëzit janë pasuria më e bollshme e kishës

Njerëzit sjellin shumë dhunti dhe aftësi në kishë

***“Dhe secilit i jepet shfaqja e Frymës për dobinë e përbashkët”.* – 1 Korintasve 12:7**

- Dhunti frymërore për shërbesë
- Aftësi për shërbim

Investimi në njerëz jep fitimin më të madh

3. Shërbesa përmbushet nëpërmjet njerëzve

“Dhe ka larmi veprueshmëri, por është i njëjti Perëndi i Cili i vepron të gjitha gjërat në të gjithë”. – 1 Korintasve 12:6

Njerëzit bëjnë shërbesë dhe u shërbehet

Vlera (gjëra) të tjera janë mjete për të ndihmuar njerëzit

Shërbesa e Jezusit ishte për zemrat e njerëzve

4. Anëtarët e kishës janë vullnetarë, jo të punësuar

Vullnetarët kanë nevojë për frymëzim

- Ata duhet të ndihen të udhëhequr nga Perëndia
- Pa pasion do të thotë pa qëllim, do të thotë pa njerëz

Vullnetarët kanë nevojë për inkurajim

- Vullnetarët kanë nevojë për sigurim për atë që po bëjnë
- Vullnetarët kanë nevojë të punojnë përtej vështirësive

Vullnetarët kanë nevojë për nxitje

- Ata nuk paguhen, kështu që kanë nevojë për diçka që t'i nxisë të vazhdojnë
- Ata kanë nevojë të nxiten me anë të ungjillit

5. Për të shmangur konfliktet

Konfliktet brenda një kishe ndodhin zakonisht midis njerëzve

Si rrjedhojë është e rëndësishme të mësosh si të merresh me njerëz në konflikt

II. Parimet e menaxhimit të njerëzve

1. Njerëzit janë unik

“Po, ti ke formuar të përbrendshmet e mia, ti më ke endur në barkun e nënës sime” – Psalmi 139:13

Ata kanë aftësi unike

Ata kanë përvoja unike

Ata kanë ide unike

Ata kanë personalitete unike

2. Njerëzit duan t'i përkasin diçkaje

Njerëzve u pëlqen të ndihen pjesë e diçkaje

Në përgjithësi njerëzit nuk parapëlqejnë të jenë të vetmuar ose vetëm

“Pastaj ZOTI Perëndi tha: “Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm; Unë do t'i bëj një ndihmë që i përshtatet”. – Zanafilla 2:18

Jezusi e pohoi nevojën tonë për bashkësi

3. Njerëzit duan të marrin pjesë

Njerëzit dëshirojnë më shumë të përfshihen sesa të jenë spektatorë

Njerëzit dëshirojnë të japin ndihmën e tyre

Njerëzit dëshirojnë të përdorin dhuntitë dhe aftësitë e tyre ku nevojiten

4. Njerëzit duan të vlerësohen

Njerëzit duhet të ndihen të dobishëm

“Të lutem për birin tim, Onesimin, që më lindi në prangat e mia, i cili dikur i padobishëm për ty, por tani mjaft i dobishëm për ty e për mua”. – Filemoni 1:10-11

Nëse njerëzit vlerësohen ato do të dalin vullnetarë

5. Njerëzit duan Respekt

“Nderoni të gjithë”. – 1 Pjetrit 2:17

Njerëzit duan të trajtohen me dinjitet

Njerëzit kanë rëndësi për Perëndinë, kështu që ata duhet të kenë të rëndësi për ne

6. Njerëzit duan miratim

“Por gëzohem për ardhjen e Stefanas dhe të Fortunatit dhe të Akaikut, sepse ata e mbushën mungesën tuaj, sepse e freskuan frymën tim dhe tuajin; prandaj njihini njerëz të tillë”. – 1 Korintasve 16:17-18

Njerëzit duhet të vlerësohen

Miratimi ndërton besim

7. Njerëzit duan drejtim

Ndajeni vizionin

- Si drejtues, duhet t’i frymëzoni dhe t’i nxisni të tjerët
- Mbajini të gjithë të fokusuar në synimet e përgjithshme

“Kur nuk ka një vizion profetik, populli bëhet i shfrenuar”.

– Fjalët e Urta 29:18

Bashkërendoni përpjekjet

- Sigurohuni që gjithkush po punon së bashku
- Mos i lejoni aktivitetet për të cilat nuk jeni në dijeni dhe të cilat nuk përputhen me vizionin ose qëllimet e kishës

Përdorni stilin më efektiv të drejtimit

- Zbatoni stile të ndryshme për situata të ndryshme sipas nevojës
- Delegoni përgjegjësitë dhe detyrat sipas nevojës

8. Njerëzit duan Informacion

Komunikoni qëllimet dhe pritshmëritë tuaja

Sigurohuni që secili e kupton rolin e tij

Mos pandehni se njerëzit e dinë diçka, tregojuni atyre

Ndani të gjithë informacionin e përshtatshëm

III. Si të menaxhosh njerëzit

Këtu kemi disa hapa bazë që mund të ndiqni për t'i menaxhuar më mirë njerëzit:

Hapi nr. 1: Përfshijini ata

Ftojini të marrin pjesë

Inkurajojini të përdorin dhuntitë e tyre frymërore

Hapi nr. 2: Respektojini ata

Vlerësoni idetë e tyre

Pyetini për idetë e tyre

Hapi nr. 3: Trajnojini ata

Ndihmujini të zhvillojnë aftësitë dhe zotësitë e tyre

Dërgojini për t'u trajnuar ose trajnojini ju vetë

Hapi nr. 4: Miratojini ata

Përgëzojini për ndihmesat e tyre

Vlerësoni arritjet e tyre

Hapi nr. 5: Shpërblejini ata

Tregoni vlerësimin tuaj me një dhuratë të vogël

Ftojini për drekë ose çojini për kafe

IV. Menaxhimi i llojeve të ndryshëm të punëtorëve të kishës

1. Menaxhimi i punonjësve të paguar të kishës

Ata janë pjesë e skuadrës së shërbesës, kështu që trajtojini mirë dhe mbështetini
Do t'ju duhet të delegoni përgjegjësi dhe jo aktivitete te ta
Puna në skuadër është përparësi, kështu që duhet të punoni të gjithë bashkë
Secili do të kërkojë fusha të qarta përgjegjësie dhe autoriteti

2. Menaxhimi i drejtuesve të kishës

Caktojini ata në fusha specifike vëmendjeje ose shërbese
Ruani autoritetin dhe kontrollin tuaj të përgjithshëm
Ofroni drejtim dhe ndihmë
Ofroni trajnim të vazhdueshëm
Ruhuni nga njerëz që përçajnë shërbesën tuaj
○ Njerëz që duan të veprojnë sipas mendjes së tyre
○ Njerëz që nuk i nënshtrohen autoritetit tuaj

3. Menaxhimi i vullnetarëve

Jini inkurajues dhe nxitës
Vendosuni objektiva specifike
Caktoni detyra me afate dhe ndiqini nga afër që të siguroheni për përfundimin e tyre
Ofroni këshillim për të zhvilluar drejtues të ardhshëm
Inkurajoni risitë ose idetë e reja
Caktojuni atyre një drejtues ose dikë nga stafi për menaxhim të drejtpërdrejtë

Ushtrim i menaxhimit të njerëzve

Udhëzime: Për secilën situatë të listuar në kolonën e majtë, shkruani parimin e duhur të menaxhimit të njerëzve:

Situata	Parimi i menaxhimit të njerëzve
1. Një anëtar i kishës vjen dhe ju thotë se dëshiron të shërbejë në skuadrën e adhurimit.	
2. Njëri nga drejtuesit e shërbesës ju kërkon një listë të të gjithë anëtarëve të kishës dhe të dhuntive të tyre frymërore.	
3. Një familje largohet nga kisha dhe ju thotë se gati nuk njihnin njeri në kishë.	
4. Të rinjtë në kishë janë të mërzitur sepse askush nuk i merr seriozisht kërkesat e tyre për burime.	
5. Drejtuesi i shërbesës të fëmijëve vjen dhe do të dijë se si përshtatet shërbesa e tyre në planin e përgjithshëm të kishës.	
6. Njerëzit në kishë janë ngurrues të dalin vullnetarë për të ndihmuar me një projekt të rëndësishëm.	
7. Dy nga drejtuesit e shërbesës në kishë kanë një mosmarrëveshje se si të arrijnë një qëllim të kishës.	
8. Një vullnetar prej shumë kohësh në shërbesën të fëmijëve papritur pushon së shërbyeri në atë shërbesë.	

Kapitulli 7

Menaxhimi i Konfliktit

“Lum ata që bëjnë paqen, sepse ata do të quhen bij të Perëndisë”.

Mateu 5:9

Çdo kishë ose drejtues shërbese duhet ta dijë se konflikti është i pashmangshëm në çdo organizatë që ka të bëjë me njerëz. Siç u tha më sipër, kisha është një aktivitet me njerëz dhe bazohet në marrëdhënie. Konflikti me Perëndinë quhet mëkat. Dhe konflikti me njëri-tjetrin mund të çojë në mëkat dhe kështu duhet të kujdesemi të mos biem në mëkatin ***“që na qarkon kaq lehtë”*** siç thuhet te **Hebrenjve 12:1**. Në predikimin në mal të Jezusit, te **Mateu 5:9**, Ai tha: ***“Lum ata që bëjnë paqen, sepse ata do të quhen bij të Perëndisë”***. Jezusi na bën thirrje të gjithëve të bëjmë paqen dhe meqë konflikte do të ndodhin, duhet të jemi të përgatitur dhe të kemi një mënyrë biblike për t’i zgjidhur ato. Në këtë kapitull, do të diskutojmë rëndësinë e trajtimit të konfliktit, cilat janë burimet dhe shkaqet e tij dhe si ta dallojmë dhe ta zgjidhim atë në mënyrë biblike.

I. Pse është kaq e rëndësishme të mësosh të menaxhosh konfliktin?

1. Në kishë ka konflikte gjatë gjithë kohës
Kurdo që keni të bëni me njerëz, ka konflikt
Ka të vërtetë absolute, por të kuptuar relativ
2. Shumica e problemeve të kishës janë të lidhura me konfliktet
Ato mund ta mbërthejnë një kishë dhe të ndalojnë rritjen e saj
Konflikte të vogla mund të kthehen në probleme të mëdha
3. Konfliktet mund ta përçajjnë lehtë një kishë
“Dhe në qoftë se një shtëpi përçahet në vetvete, ajo shtëpi nuk mund të qëndrojë”.
– **Marku 3:25**

Duke krijuar kampe ose pikëpamje kundërshtuese
Duke minuar autoritetin tuaj
4. Menaxhimi i konfliktit me efektivitet e lejon një kishë të vazhdojë rrugën përpara
Heq pengesat për rritjen
Krijon një bazë, për mirëkuptim dhe zgjidhje të konflikteve të ardhshme

II. Burimet e konfliktit

1. Midis anëtarëve
Me pikëpamje të ndryshme
Me përvoja të ndryshme
Me qëllime dhe axhenda të ndryshme
2. Midis pastorit dhe anëtarëve
Me qëllime të ndryshme
Me motivime të ndryshme
Me stile të ndryshëm
3. Midis pikëpamjeve tradicionale dhe moderne
Të formës përkundrejt lirisë
Të komoditetit përkundrejt përkatësisë
Të përputhmërisë përkundrejt fleksibilitetit
4. Midis brezave
Të tanishëm përkundrejt të asaj kohe
Të rinj përkundrejt të vjetër
Të zërit të lartë përkundrejt zërit të butë
5. Midis shërbesave
Rivalitet për burime
Rivalitet për njerëz
Rivalitet për publicitet

III. Shkaqet e konfliktit

Ka një shkak thelbësor për të gjitha konfliktet dhe vjen nga 3 burime:

1. Satani
Ai është gjithnjë rrotull duke na tunduar të mëkatojmë

“Jini të kthjellët, vigjiloni; sepse kundërshtari juaj, djalli sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë”. - 1 Pjetrit 5:8

2. Natyra jonë mëkatore
Jemi lindur mëkatarë. Është natyra jonë.

“Sepse mishi ka dëshira kundër Frymës dhe Fryma ka dëshira kundër mishit; dhe këto i kundërvihen njëra-tjetrës, që të mos bëni atë që doni”. - Galatasve 5:17

3. Bota mëkatore

Bota jonë është e korruptuar dhe do të përpiket të na korruptojë

“Sepse gjithçka, që është në këtë botë, dëshirimi i syve, dëshirimi i mishit dhe fodullëku i jetës, nuk është nga Ati, por është nga bota”. - 1 Gjonit 2:16

IV. Arsytet për konflikt

1. Vizion ose qëllime të paqarta, të vendosura pas një procesi lutjeje, meditimi dhe diskutimi.

Grupe ose njerëz të ndryshëm kanë vizione ose qëllime të ndryshme që bien ndesh me njëra tjetrën

Nuk ka aspak një vizion qendror

“Kur nuk ka një vizion profetik, populli bëhet i shfrenuar”.

- Fjalët e Urta 29:18

2. Mungesë e një plani strategjik

Nuk ka asnjë plan të vendosur që shpërndan ose priorizon burimet

Njerëzit konkurrojnë për burime bazuar në nevojat personale dhe jo ato të përbashkëta

Njerëzit konkurrojnë për burime bazuar në nevojat e tashme, jo në ato të ardhshme

Nuk ka organizim të burimeve të kishës

3. Dishepullizim i papërshtatshëm

Njerëzve nuk u janë mësuar parimet e krishtera

Nuk janë shfaqur Vlerat e krishtera nga drejtuesit e kishës

Nuk është mësuar zgjidhja e konfliktit sipas mënyrës biblike

4. Komunikim i keq

Njerëzit nuk janë në dijeni të nevojave të tjera të kishës

Njerëzit nuk komunikojnë rregullisht me njëri-tjetrin

Komunikimi është reagues në vend që të jetë proaktiv

5. Mos përballja me problemet

Konflikteve të kaluara nuk u është dhënë ndonjëherë zgjidhje

Konfliktet e tashme lihen mënjane

Konfliktet e mundshme nuk parashikohen

IV. Dallimi i konfliktit

1. Shenja të dukshme
Shpërthime emocionale
Ankesa me shkrim
Qarkullojnë thashetheme dhe murmuritje
2. Shenja (paralajmërime) më pak të dukshme
Tërheqje nga aktivitetet e kishës
Vonesa ose ngecje të projekteve
S'ka komunikim

V. Zgjidhja e konfliktit

“Por në qoftë se vëllai yt ka mëkatuar kundër teje, shko dhe qortoje vetëm për vetëm; në qoftë se të dëgjon, e fitove vëllanë tënd; por në qoftë se nuk të dëgjon, merr me vete edhe një ose dy vetë, që çdo fjalë të vërtetohet nga goja e dy ose tre dëshmitarëve. Nëse pastaj refuzon t’i dëgjojë, thuaja kishës; dhe në qoftë se refuzojë të dëgjojë edhe kishën, le të jetë për ty si pagan ose tagrambledhës”.

Mateu 18: 15-17

1. Kur jeni në konflikt me dikë tjetër:

“Ose, si mund t’i thuash vëllait tënd: “Vëlla, lër të të nxjerr lëmishten në syrin tënd”, kur ti vetë nuk e sheh traun në syrin tënd? Hipokrit, nxirre më parë traun nga syri yt dhe atëherë do të mund të shohësh mirë për të nxjerrë lëmishten në syrin e vëllait tënd”. Luka 6:42

1. Identifikoni sa e madhe është pjesa juaj e fajit në konflikt
Jini të ndershëm me veten dhe identifikoni fushat e konfliktit për të cilat jeni përgjegjës. (P.sh., fjalë të ashpra, gjuhë e pahijshme, thashetheme, padurim etj.)
2. Së pari pranoni dhe rrëfeni pjesën e konfliktit që ju përket
Kur i drejtoheni personit me të cilin jeni në konflikt, bëjeni me këtë synim,
3. Kërkoni falje për keqbërjen tuaj.
Pasi të keni kërkuar falje nga personi tjetër për dëmin që i shkaktuat dhe e merrni faljen, tani mund t’u thoni atyre për dëmin që shkaktuan kundër jush.
4. Nëse jepet falja, konflikti juaj u zgjidh.
5. Nëse personi tjetër nuk ju fal, atëherë merrni 1 ose më shumë njerëz sipas **Mateut 18:15-17**

2. Jeni thirrur për të ndërmjetësuar një konflikt:

1. Identifikoni konfliktin

Identifikoni problemin, jo simptomën

Sigurohuni që të gjithë që janë të përfshirë të bien dakord se cili ishte problemi dhe se kush është përgjegjës për çfarë gjëje. Nëse është e nevojshme shkruajini mëkatet e kryera me qëllim që ato të falen një nga një.

2. Identifikoni pjesëmarrësit

Identifikoni kush përfshihet në të vërtetë

Identifikoni si janë të përfshinë (cilat janë mëkatet e tyre?)

Përcaktoni pse janë të përfshirë (në konflikt)

3. Jepini zgjidhje konfliktit sipas Biblës

Lavdëroni Perëndinë në gjithçka bëni!

Secili person të pranojë dhe të rrëfejë fajet e tyre (**Luka 6:42**)

Secili person të kërkojë të falur

Nëse jepet falja, konflikti u zgjidh

Nëse falja nuk jepet, atëherë vijoni me dëshmitarë (sipas **Mateut 18:15-17**)

4. Zgjidheni paqësisht

Konfliktet ofrojnë mundësi

Mos mëkatoni në përpjekjen tuaj për të zgjidhur një konflikt

Mos i përkeqësoni gjërat duke hamendësuar. Gjeni faktet.

Mbani mend urdhërimet e mëdha

- Duajeni Perëndinë

“Jezus i tha: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, dhe me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde”. - Mateu 22:37

- Duajeni njëri-tjetrit

“Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: “Duaje të afërmin tënd porsivetveten”. - Mateu 22:39

VI. Lënia pas e konfliktit

1. Ne jemi përgjegjës vetëm për veprimet tona

Jetoni me mençuri

“Shikoni, pra, si të ecni me kujdes, jo si të marrët, por si të mençur...”

– Efesianëve 5:15

Perëndia është i vetmi që mund të ndryshojë zemrat

“Atëherë Fryma e Zotit do të të ngarkojë të bësh profeci me ta, dhe do të shndërrohesë në një njeri tjetër.”

- 1 Samuelit 10:6

2. Falja është fuqi

Lërimi pas jush konfliktet

Sipas fjalëve të Jezusit: “Shko dhe mos mëkato më”.

“Atëherë Jezusi i tha: “As Unë nuk të dënoj; shko dhe mos mëkato më”.– Gjoni 8:11

3. Jini paqebërës

Lum ata që bëjnë paqen, sepse ata do të quhen bij të Perëndisë”.

– Mateu 5:9

VII. Konflikti nuk është gjithnjë i dëmshëm

1. Është e mundur të kesh konflikt pa mëkat. (d.m.th. dy opinione të ndryshme se si mund të zgjidhet i njëjti problem, të dyja që punojnë së bashku për të arritur rezultatin më të mirë për të mirën e përbashkët.)

2. Konflikti mund të identifikojë diçka që duhet diskutuar. (d.m.th. një proces që duhet të rregullohet deri në detaje ose procedurë që duhet të përcaktohet më tej.)

Ushtrimi i zgjidhjes së konfliktit

Shembuj konfliktesh në kishë	Zgjidhje të mundshme
<i>1. Drejtuesit e shërbesës së të rinjve nuk janë të kënaqur me burimet dhe hapësirën që u janë caktuar dhe thonë se kanë nevojë për më shumë burime dhe hapësirë.</i>	
<i>2. Bordi juaj i pleqve nuk bie dakord me pastorin për një drejtim të ri të kishës.</i>	
<i>3. Disa nga anëtarët e moshuar të bashkësisë suaj kanë filluar të ankohen për muzikën e re të adhurimit që po luhet dhe duan që të dëgjojnë më shumë nga këngët “e vjetra”.</i>	
<i>4. Dy familje në bashkësi janë në një konflikt të ashpër ligjor për toka dhe ju shikoni anëtarët e kishës të fillojnë të mbajnë anë të ndryshme.</i>	
<i>5. Ka thashetheme se drejtuesi i adhurimit ka një marrëdhënie imorale seksuale.</i>	

Kapitulli 8

Bërja e dishepujve

“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj të gjitha kombet duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë”.

Mateu 28:19

Kisha në tokë u krijua për të tërhequr njerëz në një marrëdhënie me Perëndinë nëpërmjet personit të Jezus Krishtit. *“Sepse Perëndia nuk e dërgoi Birin e Vet në botë që ta gjykojë botën, por që bota të shpëtohet me anë të tij” (Gjoni 3:17).* Si drejtues të kishës përparësia jonë kryesore është jo të menaxhojmë kishën, por më shumë t’i **drejtojmë** të tjerët te Krishti. Ne e quajmë këtë dishepullizim. Nëse jemi duke predikuar, mësuar, ungjillëzuar, ose adhuruar, është e rëndësishme që arsyeja jonë të jetë të shikojmë “Krishtin të formuar te të tjerët” (ref. **Galatasve 4:19**). Në këtë kapitull, do të diskutojmë dishepullizimin, qëllimin e tij, parimet dhe procesin dhe rëndësinë e një vlerësimi të vazhdueshëm.

Cili është ndryshimi midis mësimit dhe dishepullizimit?

Mësimi është përcjellja e njohurisë ose e informacionit. Është për **të ditur**. Dishepullizimi është për zbatimin e asaj njohurie ose informacioni. Është për **të vepruar**.

I. Qëllimi i dishepullizimit

1. Të shikojmë Krishtin të formuar te të tjerët
“Djema të mi, që unë i lind përsëri, derisa të formohet Krishti në ju”.—
Galatasve 4:19

Ky është **QËLLIMI** i kishës

Gjithë qielli gëzohet kur gjendet një bir i humbur!

“Po kështu po ju them: ka gëzim përpara engjëjve të Perëndisë për një mëkatar të vetëm që pendohet”. - **Luka 15:10**

2. Për të zhvilluar dhuntitë frymërore të të tjerëve
“Dhe secilit i jepet shfaqja e Frymës për dobinë e përbashkët”. - **1 Korintasve 12:7**

Për të nxjerrë në pah dhuntitë që janë tashmë në anëtarësinë e kishës

Për të përdorur dhuntitë që kanë tashmë anëtarët e kishës

3. Për të trajnuar dhe pajisur të tjerët për shërbesë
“I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim në drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë”. - 2 Timoteut 3:16-17

Për shërbesë për anëtarët e kishës

Për shërbesë për ata jashtë kishës

4. Për të prodhuar rritjen e kishës
Dishepujt bëjnë dishepuj të tjerë
“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj të gjitha kombet...” - Mateu 28:19

Për ta shtrirë shërbesën tuaj te më shumë njerëz

5. Është një parakusht për të zhvilluar drejtues të tjerë
Drejtuesit e mundshëm duhet që më parë të dishepullizohen
Një besim i fortë është një kriter vendimtar për drejtuesit

III. Parimet e dishepullizimit

1. Dishepullizimi nuk mbaron asnjëherë
“Prandaj duke e lënë mësimin fillestar të Krishtit, le të kalojmë te përsosja”. – Hebrenjve 6:1

Askush nuk arrin te momenti i diplomimit dhe mbaron me aq

Udhëtimi është po aq i rëndësishëm sa dhe vendmbërritja

2. Është përparësia nr.1 e kishës
“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj të gjitha kombet”. – Mateu 28:19

Kisha u krijua për këtë qëllim

Çdo gjë në kishë përfiton prej dishepullizimit

- Ndërsa njerëzit dishepullizohen ata do të shërbejnë më shumë
- Ndërsa njerëzit dishepullizohen ata do të përfshihen më shumë në shërbesë
- Ndërsa njerëzit dishepullizohen ata do të japin më shumë oferta për kishën

3. Dishepullizimi kërkon kohë
Nuk ndodh për një ditë ose shpejt
Si i ngjiteni një mali? – Hap pas hapi

4. Dishepullizimi kërkon përpjekje
Njerëzit kanë nevojë për ndihmë
Njerëzit kanë nevojë për inkurajim
Njerëzit kanë nevojë të mbahen përgjegjës

5. Dishepullizimi kërkon njerëz
 Rekrutoni të tjerët për të ndihmuar të dishepullizoni anëtarët tuaj
 Dëshmitë janë mjete shumë efektive
 Çdo i krishterë ka nevojë për një vëlla ose motër për të ecur bashkë me ta
“Në fakt në se rrëzohen, njeri ngre tjetrin; por mjerë ai që është vetëm dhe rrëzohet, sepse nuk ka njeri që ta ngrejë!”. – Predikuesit 4:10
6. Dishepullizimi kërkon dëshirë
 Duhet të doni të *“Shikoni Krishtin të formuar te të tjerët”*. - Galatasve 4:19
 Të gjithë ne duhet të dëshirojmë të rritemi në besimin tonë
“Afrojuuni Perëndisë dhe Ai do t’ju afrohet juve” – Jakobi 4:8

IV. Procesi i dishepullizimit

A. Cilat janë shenjat e dishepullizimit?

1. Besimi

“Sepse ne ecim me anë të besimit dhe jo me të parë”. - 2 Korintasve 5:7

Një dishepull ecën me besim

Një dishepull i beson Perëndisë

Një dishepull kapet pas besimit në kohë mundimesh

2. Adhurimi

“Dhe Jezusi i tha: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, dhe me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde””. - Mateu 22:37

Një dishepull e pranon Perëndinë si sovran

Një dishepull i jep lavdi Perëndisë gjithnjë!

Një dishepull merr pjesë rregullisht në adhurim

3. Studimi i Biblës

“I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim në drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë”. - 2 Timoteut 3:16-17

Një dishepull është duke mësuar vazhdimisht për udhët e Perëndisë

Një dishepull dëshiron diturinë e Perëndisë

Një dishepull shikon për përgjigje në Fjalën e Perëndisë

4. **Lutja**

“Lutuni papushim”. - 1 Thesalonikasve 5:17

Një dishepull flet përditë me Perëndinë

Një dishepull jeton në Frymë

Një dishepull zbulon vullnetin e Perëndisë për jetën e tij

5. **Shërbimi**

“Prandaj o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se munda juaj nuk është i kotë në Zotin”. - 1 Korintasve 15:58

Një dishepull i shërben Trupit të Krishtit

Një dishepull i shërben më parë të tjerëve

Një dishepull ndjek shembullin e Jezusit

6. **Misioni dhe dëshmia**

“Por do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të më bëheni dëshmitarë në Jerusalem dhe në gjithë Judenë dhe Samarinë dhe deri në skajin e dheut”. –Veprat e Apostujve 1:8

Një dishepull u tregon të tjerëve atë që ka bërë Perëndia

Një dishepull shkon ku e drejton Perëndia

Një dishepull bën dishepuj të tjerë

B. Formulimi i një plani dishepullizimi

1. Zhvilloni një seri qëllimesh për dishepullizim
2. Identifikoni drejtuesit dhe mësuesit e mundshëm
3. Jini të qëllimshëm dhe proaktiv
4. Zhvilloni një strategji për dishepullizim, si shembulli më poshtë:

Hapi 1: Ftesë për të **adhuruar**

Gjithçka fillon me një ftesë për të shkuar për të adhuruar

Lërimi të përjetojnë praninë e Frymës së Shenjtë

Lutuni për Frymën e Shenjtë që t'i prekë në një mënyrë të veçantë

Ndërsa preken, inkurajojini të pranojnë Krishtin

Inkurajojini të bëjnë rrëfim publik të besimit të tyre

Hapi 2: Regjistrojini në një **studim biblik**

Regjistrojini në një studim biblik formal

- Mësojuni bazat e krishtërit
- Mësojuni jetesën me anë të besimit
- Mësojuni një pikëpamje biblike

Inkurajoni leximin e përditshëm të Biblës

Hapi 3: Inkurajoni jetën e **lutjes**

Siguroni trajnim për lutje

Përfshijini në shërbesë lutjeje

Hapi 4: Përfshijini në **shërbesë**

Ata duhet të shërbejnë në kishën e tyre

- Si një anëtar i kishës ata duhet ta mbështesin atë
- Si një anëtar i Trupit të Krishtit është diçka për të cilën janë urdhëruar

Le të shërbejnë sipas aftësive të tyre

- Bazuar në dhuntitë frymërore që kanë
- Talentet dhe aftësitë e tjera që zotërojnë

Hapi 5: Transferojini anëtarët në **shërbesë**

Ofroni mundësi për mision

- Lokal
- Kombëtar
- Ndërkombëtar

Ofroni trajnim për ungjillizim

- Për të përgatitur një dëshmi
- Për të përgatitur një listë njerëzish që ata t'u dëshmojnë

Trajnojini për drejtim kishe ose shërbesë

Hapi 6: Transferojini anëtarët nga të qenët dishepuj në **dishepullizimin e të tierëve**

Inkurajojini të ndihmojnë të tjerët të rriten

Trajnojini ata të trajnojnë të tjerët

C. Vlerësimi i vazhdueshëm

Vlerësoni çdo vit përparimin e dishepullizimit tuaj dhe bëni këto pyetje:

1. Sa anëtarë janë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e dishepullizimit?
2. Ku kemi sukses?
3. A po rriten në besim individualisht anëtarët tanë?
4. A po jep fryt për kishën? Për individin?
5. Cili është ndikimi në kishën tonë? Po në komunitetin tonë?

Bëni përshtatje sipas nevojës

- Inkurajoni pjesëmarrjen në klasa ose kurse të suksesshme
- Përdorni dëshmitë për të inkurajuar të tjerët

Ushtrim i bërjes së dishepujve

Udhëzime: Plotësoni tabelën më poshtë me idetë ose sugjerimet tuaja se çfarë temash duhen përfshirë në çdo nivel të trajnimit në programin e dishepullizimit të një kishe:

Besimtar i ri: Niveli 1 (*Fillimet e besimit*)

1. Kush është Perëndia?	5.	9.
2. Pagëzimi	6.	10.
3. Darka e Zotit	7.	11.
4. Përmbledhja e Biblës (BV dhe BR)	8.	12.

Besimtar që po mëson bazat: Niveli 2 (*Themelet e besimit*)

1. Krijimi - Zanafilla	5.	9.
2. Dhuntitë frymërore	6.	10.
3. Jeta e krishterë- BR	7.	11.
4. Trinia	8.	12.

Besimtar i qëndrueshëm: Niveli 3 (*Rritja e besimit*)


1. Historia e BV	5.	9.
2. Satani dhe e keqja	6.	10.
3. Besimi – Hebrenjve	7.	11.
4. Rritja frymërore	8.	12.

Besimtar i fortë: Niveli 4 (*Besimi në veprim*)

1. Mësimi i Fjalës	5.	9.
2. Drejtimi i shërbesës	6.	10.
3. Misionet	7.	11.
4. Kohët e fundit - Zbulesa	8.	12.

Pjesa 3

Menaxhimi i burimeve



Kapitulli 9

Planifikimi strategjik

“Sepse kush nga ju, pra, kur do të ndërtojë një kullë, nuk ulet më parë të llogaritë shpenzimet, për të parë nëse ka sa i duhen për ta mbaruar? Se mos, kur t’i ketë hedhur themelet e të mos mundë të ta përfundojë, të gjithë ata që e shohin, të fillojnë ta tallin”.

Luka 14:28-29

Planifikimi është një element i rëndësishëm në drejtimin e kishës. Robert Schuller, themeluesi dhe pastori i Crystal Cathedral (kishës me emrin “Katedralja e kristaltë”) në Kaliforni, thotë: *“Ata që dështojnë të planifikojnë, planifikojnë të dështojnë”*. Pasja e një plani të përcaktuar qartë ndihmon një kishë të organizojë burimet e saj dhe t’i përdorë ato në mënyrë të tillë që të arrijë vizionin e saj në mënyrën më të mirë. Pa një plan, kishat çojnë dëm burime të kufizuara dhe kohë të vlefshme, dhe në mënyrë të pashmangshme nuk ia dalin të arrijnë atë gjë për të cilën i ka thirrur Perëndia. Nëse kisha ka një plan, ai nuk e kufizon kishën në një kurs të paracaktuar veprimi, por më shumë shtron themelin mbi të cilin kisha mund të vendosë në mënyrë strategjike burimet e saj për efektivitet maksimal. Në këtë kapitull, do të diskutojmë elementet e një plani strategjik dhe si të zhvillojmë një plan për kishën tuaj.

I. Çfarë është planifikimi strategjik?

Planifikimi strategjik është arti i organizimit të aktiviteteve dhe qëllimeve për të

arritur një vizion

Një plan strategjik ju tregon se çfarë burimesh do të përdorni, kur do t’i përdorni dhe si do t’i vini në përdorim ato

II. Pse ka nevojë kisha për një plan strategjik?

Për të përcaktuar një kurs për të ardhmen

- Për të ndërtuar një themel për rritjen dhe zhvillimin e ardhshëm

“Por përse më thërrisni, “Zot, Zot” dhe nuk bëni atë që ju them? Çdonjëri që vjen tek Unë dhe dëgjon fjalët e mia dhe i bën, Unë do t’ju tregoj kujt i ngjan. Ai i ngjan njeriut që, ndërtoi shtëpinë e vet, gërmoi shumë thellë dhe e vendosi themelin mbi shkëmb. Erdhi një vërshim, përroi u sul mbi atë shtëpi, por s’e tundi dot, sepse e kishte themelin mbi shkëmb. Por, ai që i dëgjoji dhe nuk i bëri, i ngjan njeriut që e ndërtoi shtëpinë mbi dhe, pa themel; kur iu sul përroi, ajo ra menjëherë dhe rrënim i saj që i madh”. – Luka 6:46-49

- Për të drejtuar dhe udhëhequr aktivitetet dhe shërbesat e shumta të kishës

Për të shmangur humbjen e vëmendjes

- Ndhmon të mbajë fokusin në vizionin dhe misionin e kishës

“Prandaj edhe ne, duke qenë të rrethuar nga një re kaq e madhe dëshmitarësh, duke hedhur tej çdo barrë dhe mëkatin që na qarkon kaq lehtë, le të rendim me durim në garën që është përpara nesh”

– Hebrenjve 12:1

- Për të parandaluar daljen jashtë kursit

Për të përdorur burimet e saj me efektivitet dhe efikasitet

- Për të mundësuar shpërndarjen efikase të burimeve
- Për të maksimalizuar rezultatin nga burimet e disponueshme

Për të parandaluar konflikte të ardhshme

- Shmang konflikte për burimet e disponueshme
- Shmang qëllime konfliktuese

III. Çfarë përfshin një plan strategjik?

Plani strategjik ka shtatë elemente. Ato janë:

1. Deklarata e vizionit

Përshkruan rezultatin e dëshiruar që po përpiqeni të përmbushni

Cili është **qëllimi** juaj përfundimtar?

2. Deklarata e nevojave

Përcaktoni se çfarë ju duhet të përmbushni vizionin

Fokusohuni në **çfarë** ju duhet, jo si t'i siguron ato

3. Planifikimi i aktiviteteve

Identifiko cilat aktivitete do të kryeni për secilën nevojë

- Bëni një listë **se si** do të arrihet secila nevojë
- Çfarë do të bëni në mënyrë specifike

Përcaktoni se cilat aktivitete kanë përparësi përmbi të tjerat

Specifikon rendin sipas të cilit duhet të kryhen aktivitetet ose projektet

- Disa aktivitete duhet të pararendin të tjerat
- Disa aktivitete mund të jenë kritike për shërbesën tuaj

4. Përcaktimi i afateve kohore

Specifikon kur do ta kryesh një aktivitet

Identifikon se sa do të zgjasë secili aktivitet

Identifikon kur duhet të përfundojë një aktivitet

5. Burimet

Çfarë burimesh ekzistuese nevojiten?

- Specifikon ç'njerëz duhen për të kryer punën
- Identifikon pajisjet që nevojiten
- Përcakton ç'burime financiare kërkohen

Çfarë burimesh të reja nevojiten?

- Lehtësi
- Pajisje
- Njerëz

Çfarë trajnimi nevojitet?

- Njerëz për të drejtuar shërbesën
- Njerëz për të kryer shërbesën

6. Taktikat

Identifikoni mundësitë specifike që keni

Përcaktoni si t'i përdorni më mirë dhuntitë e anëtarëve tuaj

Përcaktoni si të shfrytëzoni burimet që keni tashmë

7. Organizimi

Përcaktoni se kush do të ketë autoritet dhe të çfarë lloji

- Për vendimet për projektet
- Për vendime financiare

Përcaktoni se kush do të jetë përgjegjës

- Për arritjen e qëllimeve
- Për përmbushjen e detyrave

Përcaktoni se cilat skuadra nevojiten dhe kush do të jenë pjesëtarët e tyre

IV. Si e zhvillojmë një plan strategjik?

Këtu kemi disa hapa bazë për të përdorur kur zhvillojmë një plan strategjik:

1. Organizoni një grup planifikimi strategjik

Përzgjidhni njerëz kyç

Zgjidhni ata me aftësitë ose me përvojën e duhur

Shtoni ata që kanë pasion për projektin

2. Përvijoni planin tuaj

Filloni me një përvijim të thjeshtë

Përcaktoni vizionin dhe nevojat tuaja kryesore

3. Shtojini detaje planit tuaj

Përcaktoni listën e aktiviteteve që do të zbatoni për secilën nevojë

Diskutoni me detaje elementet e secilit aktivitet

- Vendosjen në kohë
- burimet
- Taktikat
- Organizimin

Merrni parasysh të gjitha idetë dhe sugjerimet nga skuadra

Lëreni planin të zhvillohet

4. Mblidhni ide nga të tjerët në kishë

Për ta zmadhuar planin ose për të paraqitur ide të reja

Për të fituar perspektiva të tjera që mund të jenë shumë ndihmuese

Për të shmangur ngecjen ose ndeshjen me një pengesë

5. Përgatitni një dokument të shkruar

Shkrimi i një plani ndihmon për ta qartësuar atë

Mund t'ua jepni të tjerëve që të bëjnë komentet e tyre

Siguron një pikë bazë për diskutime dhe referenca

Është rezultati i prekshëm nga procesi i planifikimit

6. Finalizoni planin

Përgatitni planin strategjik të shkruar në formë përfundimtare

Lejoni anëtarët e skuadrës ta rishikojnë planin

Secili person në skuadrën planifikuese le të nënshkruaj dokumentin

- Për të vërtetuar miratimin e tyre
- Për të shmangur konflikte të ardhshme

7. Komunikojeni planin

Siguroi kopje të shkruara për drejtuesit kryesorë

Paraqitjani planin tuaj bashkësisë ose shërbesës

Ushtrim planifikimi strategjik

Deklarata e Vizionit

Qëllimi Nr. 1:

Aktivitete:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Qëllimi Nr. 2:

Aktivitete:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Qëllimi Nr. 3:

Aktivitete:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Qëllimi Nr. 4:

Aktivitete:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Kapitulli 10

Menaxhimi i parasë

“Nuk mund t’i shërbeni Perëndisë dhe mamonit”. – Mateu 6:24

Gati të gjitha shërbesat kërkojnë një nivel të caktuar financash për të funksionuar. Në mënyrë tipike, ato varen nga donacionet dhe dhuratat që marrin nga anëtarët e tyre. Si drejtues kishe, ju keni përgjegjësinë të siguroheni që të gjitha donacionet regjistrohen me saktësi dhe që të gjitha shpenzimet e shërbesës janë të përligjura dhe të shpjeguara si duhet. Në mënyrë tipike ky është një mandat ligjor, por në mënyrë akoma më të rëndësishme, është dhe një urdhërim biblik! Mirë menaxhimi i financave të kishës ose të shërbesës suaj i tregon Perëndisë dhe anëtarësisë suaj se jeni të besueshëm. Bibla na paralajmëron se dështimi për të mbajtur nivelin më të lartë të integritetit në financat tuaja çon vetëm në shkatërrim dhe vuajtje. Në këtë kapitull, do të shikojmë pse është kaq i rëndësishëm mirë menaxhimi i parasë, cilat janë parimet e tij, si të praktikojmë integritet financiar dhe cilat janë përfitimet e tij.

I. Pse është mirë menaxhimi i parasë kaq i rëndësishëm?

1. Bibla thotë se paraja mund të shkaktojë shumë probleme

“Lakmia për para është rrënja e të gjitha të këqijave”. – 1 Timoteut 6:10

Keq menaxhimi i parasë të shkakton stres dhe probleme të tjera

- Mëkate të tjera (gënjeshtër, vjedhje, lakmi, kumar, etj.)
“Drejtësia ruan atë që ndjek një rrugë të ndershme, por pabesia e rrëzon mëkatarin”. – Fjalët e Urta 13:6
- Shkatërrojnë marrëdhënie
“Ai që ecën në ndershmëri ecën i sigurt, por ai që ndjek rrugë dredharake ka për t’u zbuluar”. Fjalët e Urta 10:9

Paraja nuk është pikësnyimi, është thjesht një mjet për të arritur pikësnyimin

- Paraja është një burim që e përdorni për të arritur një qëllim
- Perëndia do të sigurojë burimet që ju duhen për punën e Tij

Pushteti i parasë mbi njerëzit është i dokumentuar shumë mirë

- Shpesh rezulton në vendime të gabuara
- Mund të rezultojë në burgosje

Paraja mund të kthehet në një zot ose idhull adhurimi

“Nuk mund t’i shërbeni Perëndisë dhe mamonit”. – Mateu 6:24

- Ndjekja e parasë do të thotë ndjekje e një zoti të rremë
- Ju humbni lirinë tuaj në Krishtin duke u bërë skllav i parasë

2. Përdorimi pavend i parasë është të mashtrosh Perëndisë

Thesaret e dhëna kishës i jepen Perëndisë

- Çdo gjë që kemi është e Tija, ne jemi vetëm administratorët (menaxherët) e Tij
- Perëndia ka një plan për thesaret tona dhe çfarë të bëjë me to

Keqpërdorimi i parasë është e njëjta gjë si ta vjedhësh

- Vidhni nga kisha
- Vidhni nga Perëndia (**Malakia 3:8**)
- Vjedhja nuk tregon dashuri

“Dashuria nuk i bën keq të afërmit”. – Romakëve 13:10

3. Keq menaxhimi i parasë është keq administrim

Keq administrimi është mos menaxhimi i parasë (burimit të Perëndisë) me mençuri

- Përdorja me mençuri e dhuratave të Perëndisë jep fryte për Mbretërinë
- Mirë menaxhimi i dhuratave të Perëndisë përlëvdon Perëndinë

4. Mirë menaxhimi i parasë ndërton besim

Nëse nuk merreni do t me paranë, nuk mund të merreni me gjërat frymërore

“Pra, në qoftë se ju nuk keni qenë besnikë në mamonin e padrejtë, kush do t’ju besojë të vërtetën?”. - Luka 16:11

Njerëzit do t’ju besojnë nëse nuk i besoni Perëndisë

“Kush është besnik në të voglat, është besnik edhe në të mëdhatë; dhe kush është i padrejtë në të voglat, është i padrejtë edhe në të mëdhatë”. – Luka 16:10

II. Cilat janë parimet e menaxhimit të parasë?

“Mos vilni asgjë më tepër nga sa ju është urdhëruar. Mos i bëni shantazh asnjëri dhe mos i bëni akuza të rreme kurrkujt”.

Luka 3:13-14

1. Jini të kënaqur me atë që siguron Perëndia për ju

Kërkojini Atij vetëm atë për të cilën keni nevojë

Besojini Perëndisë të sigurojë për nevojat tuaja

2. Mos përdorni para për qëllime për të cilat nuk u caktua

Mos kërkonit për para për një gjë e më pas i përdorni për diçka tjetër

Nderoni dhurimin e njerëzve

3. Mos i përdorni paratë e kishës për dëshira personale

Mos merrni asnjëherë para nga kisha për të kënaqur një dëshirë ose tekë personale

Mos ia jepni paratë e kishës të tjerëve për dëshirat ose tekat personale të tyre

4. Jepni llogari për të gjitha paratë e pranuar
Regjistroni të GJITHA të ardhurat dhe dhuratat e pranuar
Regjistroni qëllimin e kërkuar për të gjitha donacionet dhe respektojini ato
Mbani regjistrime të sakta dhe të përditësuara
5. Jepni llogari për të gjitha paratë e shpenzuara
Regjistroni të gjitha shpenzimet
Ruani faturat për të gjitha shpenzimet
6. Vendosni procedura për blerje të mëdha
Mos lejoni autoritetin një personi të bëjë një blerje të madhe
Vendosni një sistem të shqyrtimit dhe të baraspeshimit për të gjitha shpenzimet e mëdha
Kërkoni një formular miratimi ose ndonjë dokument tjetër për të dhënë paratë
7. Publikoni rregullisht një deklaratë financiare
Shumën e pranuar
Shumën e harxhuar
Shumën në arkë
8. Përdorni njerëz të jashtëm për të analizuar periodikisht financat e kishës
Përdorni dikë nga jashtë kishës për të inspektuar të dhënat tuaja financiare
Kryeni një auditim vjetor financiar

III. Si praktikoni mirë menaxhim të parasë?

1. Mësoni urdhrin biblik të dhënies së të dhjetës (10%)
“Do të zotohesh të japësh të dhjetën e asaj që mbjell dhe që të prodhon ara çdo vit”.- Ligji i Përtërirë 14:22

Drejtoni sipas shembullit tuaj– Jini një ofrues i të dhjetave
Inkurajoni dhuratat e fryteve të para (**Fjalët e Urta 3:9**)
2. Tregoni integritet financiar
Regjistroni të GJITHA të ardhurat dhe shpenzimet
Fillimisht paguani borxhet tuaja
Vendosni procedura për të audituar dhe inspektuar financat e kishës
3. Besojini Perëndisë për të siguruar për nevojat tuaja
Ai do t’ju japë çfarë ju nevojitet
Perëndia përkujdeset për popullin e Tij

“Porositi të pasurit e kësaj bote që të mos mbahen me të madh, dhe të mos i mbajnë shpresat në pasurinë që është e pasigurt, por në Perëndinë e gjallë, i Cili na jep gjithçka bujarisht për ta gëzuar”.

- 1 Timoteut 6:17

4. Lejojini anëtarët të shikojnë financat e kishës
Mos i fshihni financat nga anëtarët e kishës tuaj
Jini të hapur dhe të ndershëm për të gjitha faturat dhe shpenzimet

IV. Cilat janë përfitimet e mirë menaxhimit të parasë?

1. Do të ndërtoni besim me anëtarët e kishës tuaj
Nëse ju besojnë me paranë, do t’ju besojnë me gjëra të tjera
Anëtarët e kishës suaj ka më shumë gjasa t’ju besojnë dhe kështu t’ju ndjekin
Anëtarët e kishës suaj do t’ju besojnë të merreni me çështje më të mëdha financiare
2. Do të shmangni probleme të mundshme serioze
Satani nuk do të mund t’ju tundojë
Lakmia nuk do t’ju heqë gëzimin
Do të qëndroni të pastër dhe të drejtë dhe një shembull i mirë për tufën tuaj
3. Do të mësoni se çfarë mund të bëjë fuqia e Perëndisë
Do të shikoni drejtpërdrejt se si Perëndia siguron për çdo nevojë tënden
Do të zhvilloni besim në premtimet e Tij
Do të mësoni të kërkonit Atë para së gjithash
“Por para së gjithash kërkon mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e Tij dhe të gjitha këto do t’ju shtohen”.– Mateu 6:33

Ushtrimi i menaxhimit të parasë

Bëni një listë të gjërave që mund të bëni sot për të përmirësuar menaxhimin tuaj të parasë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____

Kapitulli 11

Menaxhimi i kohës

“...Zemra e njeriut të urtë di në fakt të dallojë kohën dhe gjykimin, sepse për çdo gjë ka një kohë dhe një gjykim,..”

Predikuesit 8:5-6

Pavarësisht se çfarë profesioni ose thirrjeje zgjedh ose drejt së cilës drejtohet secili prej nesh, të gjithë po përpiqemi të përmbushim shumë qëllime me burimet dhe kohën që kemi në dispozicion. Dhe ndërsa shumë burime mund të blihen ose të sigurohen, koha është i vetmi burim që nuk mund të blihet ose të rimbushet. Kur koha ikën, ka ikur përgjithnjë. Nuk mund të ripërdoret dhe nuk mund të rifitohet. Si rrjedhojë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm se si e harxhojmë kohën tonë dhe për çfarë e përdorim. Nuk e dimë dhe se sa kohë na ka mbetur gjithsej për të përdorur. Meqë askush prej nesh nuk e di se kur do të na thërrasë Zoti në shtëpi, është shumë e rëndësishme që ta shfrytëzojmë në maksimum kohën që na është dhënë dhe ta përdorim me mençuri. Shumë libra janë shkruar për menaxhimin e kohës dhe duam t’ju japim një përmbledhje të disa parimeve dhe metodave që do t’ju ndihmojnë ta menaxhoni kohën në mënyrë më efektive. Në këtë kapitull, do të shikojmë rëndësinë e menaxhimit të kohës, disa parime të menaxhimit të kohës, si ta menaxhoni kohën tuaj dhe do të japim 2 mjete për menaxhim efektiv të kohës.

I. Rëndësia e menaxhimit të kohës suaj

1. Ju ndihmon të kryeni më shumë punë për shërbesë
Ju ndihmon të përmbushni atë që keni vendosur të bëni
Ju ndihmon të fokusoheni në punën më të rëndësishme
Koha juaj harxhohet me më shumë efektivitet, gjë që jep rezultate më të mira

2. Do të shmangë kohë të çuar dëm
“Shikoni, pra, si të ecni me kujdes, jo si të marrët, por si të mençurit, duke e shfrytëzuar kohën, sepse ditët janë të liga”.
– Efesianëve 5:15-16

Nuk do të harxhoni kohë të tepërt duke bërë aktivitete me përparësi të ulët
Do të jeni të ndërgjegjshëm për kohë jo produktive
Nuk do të çoni kohën dëm duke vendosur se çfarë do të bëni pastaj

3. Do t’ju japë mundësinë të arrini afate dhe qëllime të rëndësishme
Do t’ju bëjë të vetëdijshëm për orare dhe afate që të mos i humbisni ato
Ju jep mundësinë e përparimit të qëndrueshëm drejt një qëllimi

Do t'i mbajë aktivitetet tuaja të organizuara dhe të prioritzuara

4. Ndhmon në pakësimin e stresit të punës
Pakëson shqetësimin e humbjes së diçkaje të rëndësishme
Ju jep më shumë kontroll mbi aktivitetet dhe orarin tuaj
Ju lejon të krijoni hapësirë për kohë të lirë dhe çlodhje
Çlirohuni nga gjërat dhe lërxani në dorë Perëndisë!
“Rri në heshtje para Zotit dhe prite Atë”. – Psalmi 37:7
“Ndaluni dhe pranoni që jam Perëndi”. – Psalmi 46:10
5. Ju liron kohë që të jeni të lirë kur nevojiteni
Ju mundëson të merreni me krizat afatshkurtra
Siguron që çështjet parësore të trajtohen në kohën e duhur

II. Parimet e menaxhimit të kohës

***“Kujdesu për këto gjëra dhe qëndro në to, që përparimi yt
të jetë i dukshëm për të gjithë”.***

1 Timoteut 4:15

1. Prioritizojini aktivitetet tuaja
Sipas rëndësisë
Sipas kohës kur duhen bërë
Sipas zotimeve tuaja
2. Vendosni qëllime specifike
Kur duhet bërë një detyrë
Sa kohë t'i jepni një aktiviteti
Kush duhet ta bëjë punën ose aktivitetin
3. Gruponi së bashku aktivitete të ngjashme
Gruponi së bashku aktivitete për të arritur efektivitet
 - Telefonatat, postën
 - Sesionet e këshillimit
 - Përgatitjet e predikimit dhe të mësimi
 - Takimet

Mos u hidhni sa nga një aktivitet në tjetrin

 - Mund të keni prirjen të humbni përqendrimin
 - Mund të harroni se çfarë keni bërë tashmë

Do të çoni dëm më pak kohë në ndryshimet nga një gjë në një tjetër

 - Shumë kohë humbet kur ndryshoni nga një aktivitet në tjetrin
 - Pasi e keni vënë në vijë një punë, është më efektive ta vazhdoni atë

4. Organizojini vendimet tuaja çdo ditë

Shtyjini vendimet që mund të merren më vonë

Delegojuani vendimet të tjerëve të cilët mund të jenë më të kualifikuar për t'i marrë ato

Vendosni për çështjet që kanë nevojë për vendimmarrjen tuaj menjëhershme

5. Ruani fleksibilitetin në orarin tuaj ditor

Mos krijoni një orar të ngjeshur të shfrytëzon çdo minutë

Prisni që të ndodhë atë që nuk prisni dhe ta ndikojë orarin tuaj

Lini kohë për pushime dhe vakte

Lejojini Perëndisë mundësinë për të ndryshuar përparësitë ose orarin tuaj

- Nëpërmjet një mundësie të re për shërbesë
- Nëpërmjet një perspektive të re

6. Merruni menjëherë me ndërprerjet

Mos zgjidhni një ndërprerje që mund të zgjidhet më vonë

Dëgjoni problemin dhe vendosni nëse duhet ta shtyni, delegoni apo të merrni vendimin

Nëse mund të merrni një vendim të shpejtë, merreni, por më pas vazhdoni përpara

III. Si ta menaxhosh kohën tënde

1. Organizoni ditën tuaj

Bëni një listë të gjërave për t'u bërë

- Identifikoni çfarë duhet përfunduar sot
- Identifikoni se çfarë gjëje duhet punuar sot
- Identifikoni se çfarë duhet vendosur sot
- Identifikoni se ç'gjë tjetër do të donit të bënit sot nëse do të ketë kohë

Kini qëllime dhe prioritet të mirë përcaktuara

- Mbani mend atë që është më e rëndësishme
- Mbani mend qëllimet drejt të cilave po punoni
- Bëni më parë gjërat e rëndësishme

Planifikoni pushime të shkurtra – trupi dhe mendja juaj kanë nevojë për çlodhje të herëpashershme

Përcaktoni kohën tuaj më të frytshme dhe bëjini atëherë gjërat më të rëndësishme

- Mos merrni vendime shumë të rëndësishme në fund të ditës kur jeni të lodhur
- Planifikoni aktivitete me përparësi të ulët në kohë me energji të pakët (pas dreke, etj.)

2. Jini të efektshëm

Bëjini të gjitha telefonatat në një orar të caktuar

Përcaktoni një kohë të pandërprerë për studim ose për të përgatitur predikimin

Shmangni devijimin në çështje jo thelbësore ose në konflikte

Bëjeni sot, atë që **duhet** bërë

3. Mos harxhoni kohë me gjëra që mund t'i bëjnë të tjerët
Nëse është e mundur delegojuni detyra drejtuesve të tjerë të përgjegjshëm
Shmangni bërjen e gjërave që duhet t'i bëjnë të tjerët përveç rasteve kur është patjetër e nevojshme
 - Ka një shprehje të vjetër – “Bëjini një favor dikujt dhe kthehet në punën tuaj”.
(d.m.th.- Gjërat e vogla që bëni për të tjerët mund të bëhen zakone të rregullta ose zotime që janë të vështira për t'u ndërprerë)
4. Menaxhoni takime efektive
Përfshini një devocion dhe një lutje për t'ju udhëhequr

Gjithnjë përgatisni një axhendë
 - Shmangni diskutimin e çështjeve që nuk janë në axhendë
Sepse njerëzit nuk janë të përgatitur ta diskutojnë çështjen
Sepse zakonisht ato nuk kanë lidhje me temën që diskutohet
 - Qëndrojeni besnik axhendës dhe afatit kohor
Diskutoni vetëm propozimet dhe rekomandimet për të cilat mund të merren vendime
 - Mos kini tema diskutimi përveç se kur doni të merrni informacion
 - Do ta ndihmojë që takimi të qëndrojë i përqendruar në temat kryesore
 - Do të japë mundësinë që diskutimet të çojnë në vendime
Jepni detyra
 - Krijon zotërim gjatë procesit dhe punë në skuadër
 - E bën çdokënd në takim të përgjegjshëm
Dokumentoni diskutimet, vendimet dhe marrëveshjet përmes shënimeve të takimit
 - Dokumentoni çfarë u diskutua
 - Dokumentoni për çfarë u vendos
 - Dokumentoni detyrat që njerëzit morën përsipër

IV. Dy mjete efektive për menaxhimin e kohës

1. Krijoni një fletë orari (ose përdorni një kalendar ditor ose mujor)
Përdoreni për të ndjekur kohën tuaj gjatë një jave ose për të planifikuar ngjarje
 - Ju ndihmon të analizoni se ku harxhohet koha juaj
 - Mund të përdoret për të planifikuar orarin tuaj javor
2. Bëni një listë të gjërave për t'u bërë
Do t'ju ndihmojë të organizoni ditën, javën, ose muajin
Do të kryeni më parë punën më të rëndësishme të shërbesës
Ndihmon të shmangë harresën e aktiviteteve dhe zotimeve të rëndësishme

Ushtrim për menaxhimin e kohës suaj

Përdorni planifikuesin javor më poshtë dhe hiqni mënjatë kohën që keni si ditë pushimi, për studimin e Biblës, përgatitjen e predikimit, adhurimin javor etj. për javën tjetër. Koha e mbetur më pas mund të plotësohet sipas nevojave tuaja.

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E dielë
8:00 am							
8:30							
9:00							
9:30							
10:00							
10:30							
11:00							
11:30							
12:00 pm							
12:30							
1:00							
1:30							
2:00							
2:30							
3:00							
3:30							
4:00							
4:30							
5:00							
5:30							
6:00							
6:30							
7:00							
7:30							
8:00							
8:30							
9:00							
9:30							

Shembull i menaxhimit të kohës suaj

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E dielë
8:00 am		Telefonata		Studim i Biblës		Familja	
8:30		Telefonata		Studim i Biblës		Familja	
9:00		Zyrë		Studim i Biblës	Këshillim	Familja	Adhurim
9:30		Zyrë		Studim i Biblës	Këshillim	Familja	Adhurim
10:00		Zyrë			Këshillim	Familja	Adhurim
10:30		Zyrë			Këshillim	Familja	Adhurim
11:00							Adhurim
11:30							Adhurim
12:00 pm	Drekë	Drekë	Drekë	Drekë	Drekë		Drekë
12:30	Drekë	Drekë	Drekë	Drekë	Drekë		Drekë
1:00				Vizita			
1:30				Vizita			
2:00			Përg. predikimi	Vizita			
2:30			Përg. predikimi	Vizita			
3:00			Përg. predikimi				
3:30			Përg. predikimi				
4:00							
4:30							
5:00	Darkë	Darkë	Darkë	Darkë	Darkë		
5:30	Darkë	Darkë	Darkë	Darkë	Darkë		
6:00							
6:30							
7:00		Takim				Përg. e të dielës	
7:30		Takim				Përg. e të dielës	
8:00		Takim				Përg. e të dielës	
8:30						Përg. e të dielës	
9:00							
9:30							

Kapitulli 12

Menaxhimi i informacionit

**“Të urtët grumbullojnë njohuri”.
Fjalët e Urta 10:14**

Një nga burimet e kishës që nuk vihet shumë re është informacioni. Ky mund të jetë informacioni për anëtarët e kishës, ose informacioni për shërbesat, aktivitetet ose burimet e saj që ka në dispozicion. Ka një pasuri informacioni në dispozicion për të na ndihmuar të bëjmë shërbesën për të cilën jemi thirrur dhe është e rëndësishme të dimë se ku ndodhet ky informacion ose si mund ta marrim. Disa lloje informacioni duhet të mbledhen dhe të ruhen nga kisha, në veçanti informacion për anëtarët dhe aktivitetet e tyre ose dhuntitë e tyre, etj. Informacion tjetër tani është i disponueshëm në internet ose në një bibliotekë ose librari. Për ta aksesuar informacionin që na nevojitet në kohën e duhur, duhet ta kemi lehtësisht të disponueshëm ose të dimë se ku është për ta marrë. Ky është procesi i menaxhimit të informacionit. Një kompjuter është shumë i dobishëm për ta bërë këtë, por nuk ju duhet një kompjuter për të ruajtur informacion. Mund të përdorni metoda të tjera që mund të jenë po aq efektive. Në këtë kapitull do të shohim rëndësinë e menaxhimit të informacionit, disa parime të menaxhimit të informacionit dhe si të mbledhim dhe të ruajmë informacion për përdorim të mëvonshëm në shërbesë.

I. Rëndësia e menaxhimit të informacionit

***“Çdo njeri i matur vepron me dituri.”
Fjalët e Urta 13:16***

1. Rrit njohurinë tuaj për burimet që keni në dispozicion
Informacion për dhuntitë frymërore dhe aftësitë e anëtarëve tuaj
Informacion për burime të tjera të kishës (libra, video, studime Bible etj.)
Informacion për aktivitetet dhe shërbesat e kishës tuaj (kush, çfarë dhe ku)
2. Do të shmangë çuarjen dëm të kohës duke kërkuar për informacion
Nuk do të harxhoni shumë kohë duke kërkuar për dokumente
Do të dini te kush të shkoni për nevoja të veçanta
Nuk do të keni nevojë të kontaktoni njerëz për të marrë informacionin që kërkon
3. Do t’ju japë mundësinë të merrni vendime më të mira
Vendimet janë po aq të mira sa informacioni mbi të cilin janë bazuar
Pasja në dispozicion e informacionit kur nevojitet shpesh është kritike
Të dish është gjithnjë më mirë se të hamendësosh

4. Është thelbësor për planifikim të mirë
Një plan është po aq i mirë sa informacioni mbi të cilin është bazuar
Informacioni i mangët të çon në rezultate të mangëta
Nuk mund ta planifikoni atë gjë që nuk e dini
5. Ju jep shanse të shikoni mundësi për shërbesë
Të dish se çfarë ke në dispozicion ju jep mundësinë të jeni krijues
Ju bën të mundur të ndiqni mundësi për shërbesë
 - Bazuar në njohurinë për dhuntitë dhe pasionet e anëtarëve
 - Bazuar në njohurinë për nevojat e komunitetit

II. Parimet e menaxhimit të informacionit

“Kush shkon me të urtët bëhet i urtë”.

Fjalët e Urta 13:20

1. Mblidhni dhe ruani vetëm informacionin që doni ose që keni nevojë
Informacionin që nevojitet për vendime
Informacion që nevojitet për funksionimin e kishës
Informacion që nevojitet për të ndihmuar anëtarët për të gjetur rolin e tyre në kishë
2. Rifreskoni informacioni rregullisht
Informacioni vjetrohet shpejt dhe nganjëherë nuk është aktual
Zhvilloni procese për të kapur informacionin
 - Fletë pjesëmarrjeje në klasa
 - Formularë informacioni për anëtarët e rinj
 Përdorni drejtuesit e kishës për të mbledhur informacion
 - Pjesëmarrësit e shërbesës
 - Rezultatet, aktivitetet e shërbesës
 Përdorni një formular rifreskimi vjetor (për të dhëna) për anëtarët e kishës
 - Ndryshim adrese
 - Numra të rinj telefoni, adresa email-i
3. Mbroni informacionin personal
Mos botoni ose printoni informacion personal përveç kur bie dakord anëtari
Ruajini në një dollap me çelës
Ruani konfidencialitetin
4. Ruajeni informacionin në mënyrë që të aksesohet lehtësisht
Sipas funksionit (tema, qëllimi, përdorimi, etj.)
Sipas shërbesës
Sipas emrit të anëtarit

5. Kini një plan për përdorimin e informacionit
 - Mos mblidhni thjesht informacion pa pasur një plan për ta përdorur
 - Dini qëllimin për secilin lloj informacioni që mblidhet
 - Nëse nuk ju duhet, mos e mblidhni e as mos e ruani atë
6. Menaxhoni informacionin
 - Mos supozoni se po mblidhet ose po ruhet
 - Mbajeni të përditësuar
 - Rishikoni rregullisht nevojat tuaja për të dhëna

III. Si të menaxhosh informacionin

1. Përcaktoni informacionin që doni ose që ju nevojitet
 - Anëtarë të kishës
 - Aktivitete të kishës
 - Burime të kishës (libra, dhoma, pajisje etj.)
 - Burime komuniteti (hotele, dhoma për konferenca, furnizues lokalë, etj.)
2. Mblidhni dhe ruani informacion për anëtarët e kishës
 - Emrat, adresën dhe informacionin e kontaktit (telefon, email)
 - Dhuntitë e tyre frymërore
 - Aftësitë dhe përvojën e tyre
 - Aktivitetet dhe lidhjet e tyre të kishës
3. Mblidhni dhe ruani informacion për aktivitetet e kishës
 - Pjesëmarrjen në adhurim
 - Pjesëmarrjen në klasën e Biblës
 - Pjesëmarrjen në grupet e vogla
4. Zhvilloni një sistem për organizimin dhe gjendjen e vendit të informacionit specifik
 - Ku ruhet informacioni (Dosje kompjuterike ose fizike)
 - Faqe të dobishme interneti
 - Kush e ka informacionin
5. Zhvilloni një plan për përdorimin e informacionit
 - Çfarë informacioni do të mblidhet
 - Cili është qëllimi për secilin tip të informacionit
 - Kush është përgjegjës për mbledhjen e informacionit
6. Caktojini dikujt përgjegjësinë për menaxhimin e informacionit
 - Mbledhja e informacionit është e vazhdueshme
 - Siguron një burim qendror për të gjithë informacionin
 - Mundëson planifikimin dhe mirëmbajtjen e duhur

Ushtrim i planit të menaxhimit të Informacionit

Përdorni planin e mëposhtëm për të zhvilluar një plan informacioni për kishën ose shërbesën tuaj:

Informacion për të mbledhur	Qëllimi	Kush do ta mbledhë?	Si do ta mbledhë?

